

Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”

Fakulteti i Edukimit

Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor- Master



TEMË MASTERI

**Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor në komunën e
Gjilanit**

Gjilan, 2024

Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”

Fakulteti i Edukimit

Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor- Master



TEZA MASTER

Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor në komunën e Gjilanit

Mentorja:

Prof.Asoc. Dr.Voglushe Kurteshi

Kandidatja:

Edlirë Zymberi

Gjilan,2024

Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”

Fakulteti i Edukimit

Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor- Master



TEZA MASTER

Lënda: Mësimdhënie në teori dhe praktikë

Titulli i punimit: Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor në komunën e Gjilanit

Emri dhe mbiemri: Edlirë Zymberi

Statusi i studentes: E rregullt

ID Regjistri: 22151015

Niveli i studimeve: Master

Departamenti: Edukim

Programi i studimit: Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor

Mentorja e punimit: Prof. Asoc.Dr.Voglushe Kurteshi

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë, Edlirë Zymberi deklaroj se ky punim tezë masteri është punuar, duke i respektuar rregullatë e një punimi teze masteri posaçërisht rregulloren e UKZ-së.

Unë, gjithashtu, deklaroj se për të punuar këtë punim tezë masteri kam përdorur literaturë të ndryshme, punime dhe hulumtime shkencore në lidhje me temën e këtij punimi.

Po ashtu, deklaroj se ky punim është punuar, duke respektuar autorësinë e çdo burimi të informacioneve dhe rregullave për një punim të mirëfilltë shkencorë.

Gjithashtu, deklaroj se gjatë shkrimit të këtij punimi kam respektuar plotësisht rregullat etike të punës shkencore dhe akademike të UKZ-së.

FALËNDERIM

Për kryerjen e punimit të tezës së masterit shfrytëzoj rastin të falenderoj të gjithë personat, të cilët më kanë ndihmuar, sidomos një falënderim i veçantë për komisionin përbërës, i cili me këshillat dhe sugjerimet e tyre e ka bërë të mundur që ky punim i tezës së masterit të marrë formën më të mirë të mundur të një punimi.

Përcaktimi i temës së këtij punimi, solli dilemat e vështirësitë e para, të cilat u tejkaluan pas shumë analizash e hamendjesh, e veçanërisht pas shumë konsultash me mentoren time, prof. Voglushe Kurteshi. Për të pasqyruar më efektëshëm, më argumentueshëm, me burime të shkruara dhe material për këtë temë, janë marrë parasysht materialet bazë: si burimet e botuara, artikujt dhe këshillat e sugjerimet e mentores time, Prof.Asoc.Dr. Voglushe Kurteshi, të cilën e falënderoj shumë.

Një falënderim shumë i veçantë për familjen time, e cila ishte çdoherë pranë meje gjatë kohës së studimeve, duke më mbështetur gjithmonë.

DEDIKIM

Babit, nanit dhe Malit.

Shpresoj se jeni krenarë me mua!

ABSTRAKTI

Arsimi gjithëpërfshirës në arsimin fillor nënkupton përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara së bashku me faktorë të ndryshëm mbështetës nga të cilët varet cilësia e arsimit gjithëpërfshirës. Cilësia e mbështetjes bazohet në një qasje individuale ndaj fëmijës, në përfshirjen e të gjithë personave të rëndësishëm për fëmijën, në bashkëpunimin e ekspertëve dhe mësimitdhënësëve, në një mjedis gjithëpërfshirës dhe në vlerësimin e cilësisë së gjithëpërfshirjes.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të vlerësojë disponueshmërinë e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor, format e mbështetjes për fëmijët me nevoja të veçanta në arsimin fillor në komunën e Gjilanit si dhe lidhja me nevojat e vlerësuara përmes hulumtimit anketues dhe t'u përgjigjet pyetjeve rreth mundësisë së përfshirjes në institucionet e rregullta të arsimit fillor.

Hulumtimi mblodhi të dhëna për fëmijët me nevoja të veçanta si dhe përfaqësimin e mësimitdhënësve mbështetës që frekuentojnë institucionin, programet e ofruara nga institucioni, numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta të përfshirë në arsimin fillor në lidhje me numrin e përgjithshëm të fëmijëve, llojet e mbështetjes që u ofrohet fëmijëve për të ndihmuar punën me fëmijët me nevoja të veçanta.

Rezultatet e hulumtimit na japin rekomandime për statistikën e përgjithëshme të përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në komunën e Gjilanit të marrura nga DKA si dhe rezultatet e marrura nga hulumtimi i realizuar me mësimitdhënës të shkollave fillore në këtë komunë tregojnë se kemi fëmijë me vështirësi të ndryshme ku (13.8%) janë nxënësit me nevoja të veçanta me dëmtim intelektual, (2.1%) dëmtim në të dëgjuar, (6.4%) - dëmtim në të parë, (4.3%) - dëmtime të shumëfishta, (4.3%) - autizëm, (8.5%) hiperaktivitet.

Fjalët kyçe: *nxënës, përfshirje, nevoja të veçanta, kurrikulë, mësimitdhënës.*

ABSTRACT

Inclusive education in primary education implies the inclusion of children with disabilities together with various supporting factors on which the quality of inclusive education depends. the quality of support is based on an individual approach to the child, on the involvement of all important persons for the child, on the cooperation of experts and teachers, on an inclusive environment and on the evaluation of the quality of inclusiveness.

The purpose of this research is to assess the availability of children's inclusion in the educational system as well as the forms of support for these children with learning difficulties in primary education in the municipality of Gjilan, as well as the connection with the needs assessed through the survey research answers questions about the possibility of inclusion in regular primary education institutions.

The research collected data on children with learning difficulties as well as the representation of support teachers who attend the institution, the programs offered by the institution, the number of children with disabilities included in primary education in relation to the total number of children the types of support offered to children to help work with children with disabilities.

The results of the research give us recommendations for the general statistics of the inclusion of children with special needs in the municipality of Gjilan received by DKA, as well as the results obtained from the research carried out with the teachers of primary schools in this municipality show that we have children with various difficulties where (13.8%) are special needs students with intellectual impairment, (2.1%) hearing impairment, (6.4%) - hearing impairment, (4.3%) multiple impairments, (4.3%) autism , (8.5%) hyperactivity

Keys word: students, inclusion, special needs, curriculum, teacher

| | |
|--|----|
| Përmbajtja | |
| <i>DEKLARATA E AUTORËSISË</i> | 4 |
| <i>FALËNDERIM</i> | 5 |
| <i>DEDIKIM</i> | 6 |
| <i>ABSTRAKTI</i> | 7 |
| <i>ABSTRACT</i> | 8 |
| <i>Lista e tabelave</i> | 11 |
| <i>Lista e Grafikoneve</i> | 13 |
| <i>HYRJE</i> | 14 |
| <i>I. FËMIJËT ME NEVOJA TË VEÇANTA</i> | 15 |
| 1.1. Emërtimet për fëmijët me nevoja të veçanta | 18 |
| 1.2. Fëmijët me nevoja të veçanta dhe emërtimi i tyre në shoqërinë sot | 19 |
| 1.3. Baza ligjore e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta | 20 |
| 1.4. Trajtimi i fëmijëve me nevoja të veçanta | 22 |
| <i>II. PËRFSHIRJA E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË SISTEMIN SHKOLLOR NË KOMUNËN E GJILANIT</i> | 24 |
| 2.1. Statistikat për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta nga DKA | 24 |
| 2.2. Statistikat për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta nga Shoqata e paraplegjikëve dhe e paralizës së fëmijëve të Gjilanit- HANDIKOS..... | 25 |
| 2.3. Statistikat për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta nga Qendra Sociale | 26 |
| 2.4. Përfshirja e familjes në aspektin e vetëdijësimit për mosmohimin e arsimit | 27 |
| 2.5. Përfshirja e fëmijëve në moshën e hershme- Raport në çerdhe..... | 28 |
| <i>III. NDIKIMI I MËSIMDHËNËSIES NË PËRFSHIRJEN DHE SHKOLLIMIN E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA</i> | 30 |
| 3.1. Plani Individual i Arsimit | 31 |
| 3.2. Metodatat, teknikat dhe strategjitë e përshtatshme për fëmijët me nevoja të veçanta..... | 33 |

| | |
|---|----|
| IV. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT | 36 |
| 4.1. Qëllimi i hulumtimit..... | 36 |
| 4.2. Objektivat e hulumtimit | 36 |
| 4.3. Pyetjet e hulumtimit | 36 |
| 4.4. Hipotezat e punimit | 37 |
| 4.5. Populacioni dhe mostra | 37 |
| 4.6. Instrumentet e hulumtimit | 38 |
| 5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE | 40 |
| 5.1. Argumentimi i pyetjeve të hulumtimit | 70 |
| 6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME | 71 |
| 6.1. Përfundime | 71 |
| 6.2. Rekomandime | 73 |
| 7. BIBLIOGRAFIA | 74 |
| SHTOJCAT | 77 |

Lista e tabelave

| | |
|---|----|
| Tabela 1- Mosha juaj..... | 39 |
| Tabela 2- Gjinia juaj..... | 41 |
| Tabela 3- Përvoja e punës në arsimin fillor | 42 |
| Tabela 4- Niveli i kualifikimit akademik | 43 |
| Tabela 5- Shkolla mundëson dhe mbështet gjithëpërfshirjen në çdo rast | 44 |
| Tabela 6- A keni nxënës me nevoja të veçanta në klasën tuaj ?..... | 45 |
| Tabela 7-Sa nxënës me nevoja të veçanta keni në klasën tuaj ?..... | 46 |
| Tabela 8-Puna me nxënës me nevoja të veçanta është sfidë në punën time..... | 47 |
| Tabela 9-Cilës kategori i takojnë nxënësit me nevoja të veçanta që keni në klasën tuaj ?..... | 48 |
| Tabela 10-Shkolla ku punoni a ka burime të mjaftueshmë didaktike, burime dhe mjete ndihmëse për punën me nxënësit me nevoja të veçanta ?..... | 50 |
| Tabela 11-Sa janë të përfshirë në procesin mësimor nxënësit me nevoja të veçanta në klasën tuaj ?..... | 51 |
| Tabela 12-A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon në zhvillimin e empatisë tek fëmijët e tjerë ?..... | 53 |
| Tabela 13-A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon në zhvillimin e aftësive sociale ?..... | 55 |
| Tabela 14-A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon në zhvillimin e një kulture gjithëpërfshirëse ? | 57 |
| Tabela 15-A kanë asistente nxënësit me nevoja të veçanta në klasën tuaj ?..... | 59 |
| Tabela 16-Sa iu ndihmon mësimdhënësia mbështetëse nxënësve me nevoja të veçanta që janë në klasën tuaj ? | 60 |
| Tabela 17-Nxënësit me nevoja të veçanta që janë në klasën tuaj a kanë Plan Individual të Arsimit ?..... | 62 |
| Tabela 18- Kush mban mësim plotësues me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollën tuaj ? ... | 64 |
| Tabela 19-Sa punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollën tuaj shërbimi profesionist ? | 66 |
| Tabela 20-Cilat nga këto strategji përdorni me nxënësit me nevoja të veçanta ?..... | 68 |

Tabela 21-Mësimdhënësit duhet të marrin pjesë në trajnime profesionale për të punuar me nxënësit me nevoja të veçanta69

Lista e Grafikoneve

| | |
|---|----|
| Grafikoni 1- Mosha juaj..... | 40 |
| Grafikoni 2- Gjinia juaj | 41 |
| Grafikoni 3- Përvoja e punës në arsimin fillor | 42 |
| Grafikoni 4-Niveli i kualifikimit akademik | 43 |
| Grafikoni 5-Shkolla mundëson dhe mbështet gjithëpërfshirjen në çdo rast | 44 |
| Grafikoni 6-A keni nxënës me nevoja të veçanta në klasën tuaj ? | 45 |
| Grafikoni 7-Sa nxënës me nevoja të veçanta keni në klasën tuaj ?..... | 46 |
| Grafikoni 8-Puna me nxënës me nevoja të veçanta është sfidë në punën time | 47 |
| Grafikoni 9-Cilës kategori i takojnë nxënësit me nevoja të veçanta që keni në klasën tuaj ?..... | 48 |
| Grafikoni 10-Shkolla ku punoni a ka burime të mjaftueshmë didaktike, burime dhe mjete ndihmëse për punën me nxënësit me nevoja të veçanta ? | 50 |
| Grafikoni 11-Sa janë të përfshirë në procesin mësimor nxënësit me nevoja të veçanta në klasën tuaj ? ... | 51 |
| Grafikoni 12-A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon në zhvillimin e empatisë tek fëmijët e tjerë ?..... | 53 |
| Grafikoni 13-A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon në zhvillimin e aftësive sociale ? | 55 |
| Grafikoni 14-A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon në zhvillimin e një kulture gjithëpërfshirëse ? | 57 |
| Grafikoni 15-A kanë asistente nxënësit me nevoja të veçanta në klasën tuaj ? | 59 |
| Grafikoni 16-Sa iu ndihmon mësimdhënësia mbështetëse nxënësve me nevoja të veçanta që janë në klasën tuaj ? | 60 |
| Grafikoni 17-Nxënësit me nevoja të veçanta që janë në klasën tuaj a kanë Plan Individual të Arsimit ? .. | 62 |
| Grafikoni 18-Kush mban mësim plotësues me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollën tuaj ?..... | 64 |
| Grafikoni 19-Sa punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollën tuaj shërbimi profesionist ? | 66 |
| Grafikoni 20-Cilat nga këto strategji përdorni me nxënësit me nevoja të veçanta ? | 68 |
| Grafikoni 21-Mësimdhënësit duhet të marrin pjesë në trajnime profesionale për të punuar me nxënësit me nevoja të veçanta | 69 |

HYRJE

Mësimdhënia si proces i vazhdueshëm me gjenerata dhe nxënës të ndryshëm, bën të mundur që ju si mësimdhënës të përballeni me nxënës me nevoja të veçanta, por si t'i përfshihë ata në proces mësimor është një mendim që të përcjellë gjatë gjithë kohës duke pasur parasysh vështirësitë dhe nevojat që kanë ata nxënës.

Në vitet e fundit edhe zyrtarisht nga MASHT përdoret termi nxënës me nevoja të veçanta përmes të cilit kuptohen të gjithë nxënësit, të cilët kanë vështirësi në procesin e arsimimit si pasojë e dëmtimeve si: prapambetje mendore, dëmtime në të parë, dëmtime në të dëgjuar, vështirësi në komunikim, çrregullime emocionale dhe të sjelljes, dëmtime fizike, vështirësi specifike në të mësuar, por edhe nxënës që kanë vështirësi në arsimim për shkak të gjuhës, etnisë, statusit ekonomik-social apo çfarëdo qofshin ato. (Zabeli, 2022)

E rëndësishme si për nxënësit ashtu edhe për mësimdhënësin është që të përfshihen të gjithë nxënësit në procesin mësimor pa marrë parasysh vështirësitë apo nevojat e tyre.

Duke marrur parasysh numrin e madh të nxënësve me nevoja të veçanta në arsimin fillor brenda komunës së Gjilanit konsiderojmë se kjo temë do të paraqesë saktësisht sa përfshihen fëmijët me nevoja të veçanta. Po ashtu, ky hulumtim do të ndihmojë mësimdhënësit, të cilët kanë nxënës me nevoja të veçanta në klasat e tyre, si dhe gjetjen e metodave dhe teknikave në përfshirjen e këtyre nxënësve në proces mësimor.

Gjithashtu, bazuar në përvojën personale si mësimdhënëse klasore, me ç'rast në klasë kam një nxënëse me nevoja të veçanta kam hasur në vështirësi në përfshirjen e saj në procesin mësimor, bashkë me nxënësit e tjerë, duke ndikuar këtu edhe numri i madh i nxënësve në klasë.

I. FËMIJËT ME NEVOJA TË VEÇANTA

Për fëmijët me nevoja të veçanta gjatë kohëve të fundit janë bërë studime dhe kërkime të shumta, ku si shkak kryesor mund të llogaritet rritja e numrit të përfshirë të fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor, pastaj mungesa e trajnimeve për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta e ka bërë më të vështirë punën e mësimit me këta nxënës.

Duke e marrur parasysh Kornizën Kurrikulare të Kosovës si dokument që luan një rol të rëndësishëm në sistemin arsimor, vërejmë se si parim kryesor për zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Kurrikulare në arsim kemi parimin e gjithëpërfshirjes, që i referohet të drejtës së secilit fëmijë dhe të ri për qasje dhe përfshirje të barabartë në arsimim cilësor. (<https://masht.rks.gov.net/korniza-kurrikulare-e-arsimit-parauniversitar-te-republikes-se-kosoves/>)

Përfshirja është pjesëmarrja e të gjithë nxënësve/fëmijëve në një proces ose aktivitet pa marrë parasysh dallimet fetare, etnike ose vështirësive që kanë ata. Një përfshirje e suksesshme do të thotë që fëmijët të përfshihen në mënyrë aktive në vendimmarrje që kanë të bëjnë me ta ose që ndikon në jetët e tyre. (Bejtullahu, 2007)

“Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara për ta është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore”. (Assessing factors that contribute to the practical implementation of inclusive education, 2012)

Nevojat e veçanta arsimore dhe aftësitë e kufizuara është një term që përshkruan vështirësitë dhe aftësitë e kufizuara që mund të ndikojnë në aftësinë për të mësuar. (Zhapaj, Sulaj, & Caushi, 2019)

Historikisht ka pasur përpjekje për të bërë përcaktime sa më rigoroze për fëmijët e veçantë, për rrjedhojë ekzistojnë shumë përcaktime, që dëshmojnë për një zhvillim të natyrshëm të kësaj fushe, drejt saktësimin në mënyrë gjithnjë e më shkencore të objektit të vet. Do të pëlqenim t'i referoheshim njërit prej tyre, atij më të pranueshmit të viteve të fundit që thotë se fëmija i veçantë është një i tillë, që ndryshon prej një fëmije mesatar ose normal për nga:

- Karakteristikat mendore

- Aftësitë shqisore
- Aftësitë komunikative
- Sjellja sociale
- Karakteristikat fizike (Turku, 2002)

Sipas Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDKPAK) (2006) jepet ky përkufizim: *“Me termin “nxënës me aftësi të kufizuara” do të kuptojmë të gjithë ata fëmijë apo të rinj, që kanë **dëmtime** fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri dhe edukim në baza të barabarta me të tjerët e, për rrjedhojë, kanë nevojë për trajtim të veçantë.”* (Reçica-Havolli, 2014)

Sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar (Neni 39), një fëmijë ka vështirësi në të nxënë nëse:

- ka vështirësi dukshëm më të mëdha në mësim sesa shumica e fëmijëve të asaj moshe; ose
- ka një aftësi të kufizuar e cila e ndalon ose e pengon atë nga përdorimi i pajisjeve arsimore të llojit që ofrohen në përgjithësi për fëmijët e moshës së tij në institucionet arsimore dhe aftësuese. (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>)

Trajtimi i personave me aftësi të kufizuara ka kaluar nëpër shumë faza gjatë historisë së shoqërive, që nga diskriminimi i skajshëm përmes kërkimfaljes e deri te pranimi përfundimtar.

Deri në shek. XIX ai trajtim, në përgjithësi, ka lëvizur në dy drejtime.

- Në rastin e parë, fëmijët me nevoja të veçantakanë mbetur në familjet e tyre, larg syve të opinionit, janë fshehur dhe kanë qenë turp për familjen.
- Në rastin e dytë, ata kanë qenë të ndarë nga familjet dhe janë dërguar në institucione speciale, ku u është ofruar ushqim dhe strehim, por pa asnjë trajtim special, megjithëse përbërja ka qenë heterogjene sipas llojit të aftësive të kufizuara. (Zabeli, 2022)

Kategoritë tipologjike të fëmijëve me nevoja të veçanta përfshijnë:

- Çrregullimet emocionale dhe të sjelljes
- Dështim/ vonesë
- Paaftësi mendore, fizike/motorike
- Dëmtim të shikimit

- Dëmtim të dëgjuarit
- Çrregullime gjuhësore
- Çrregullime/ vështirësi/ paaftësi në të nxënë (Gal, 2010)

Ligji për Arsim Parauniversitar përcakton arsimin gjithëpërfshirës sipas dispozitave të Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Fëmijës (1989), Deklaratës së UNESCO-s të Salamankës (1994) dhe Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2007). (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>)

Arsimi është çelësi për gjithëpërfshirjen. Arsimi është vendimtar për fillimet e çdo njeriu. Të jesh në gjendje të organizosh arsimin në një mënyrë gjithëpërfshirëse kërkon përkushtim ndaj idesë së përfshirjes dhe pasurisë së diversitetit. (Vasilica, 2010)

Në arsim, gjithëpërfshirja është një proces i respektimit të ndërsjellë të dallimeve të çdo nxënësi dhe nevojave të tij/saj, në të cilin fokusi vendoset tek nxënësi. Nga ana tjetër, sistemi arsimor duhet të përballlet me sfidat me të cilat përballen të gjithë nxënësit, përfshirë edhe nxënësit me nevoja të veçanta arsimor. (Stankovska, 2011)

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka zhvilluar politika dhe praktika arsimore të cilat mbështeten mbi parimin e gjithëpërfshirjes, ku rëndësi e veçantë i kushtohet arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Dokumentet e reja të miratuara nga MASHT-i, si: Ligji për arsimin parauniversitar në Kosovë, Korniza e Kurrikulës etj. përkrahin gjithëpërfshirjen dhe mbrojnë të drejtën për qasje në arsim për të gjithë pa dallim aftësie, moshe, gjinie, race, prejardhjeje sociale etj. (Reçica-Havolli, 2014)

Parimi i arsimit gjithëpërfshirës nënkupton:

- Institucionet arsimore dhe aftësuese duhet të akomodojnë të gjithë fëmijët, pa dallim të kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo të tjera dhe duhet të promovojë integrimin dhe kontaktin në mes të fëmijëve;
- Mbështetja përkatëse duhet të ofrohet bazuar në nevojat intelektuale të nxënësve; dhe
- Mjediset speciale arsimore apo shkollat speciale arsyetohen vetëm pasi që nga vlerësimi i ekspertit del se nuk është praktike të regjistrohet ndonjë fëmijë në shkollën e rregullt publike apo në institucionin e aftësimin.

(<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>)

Sipas Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2007), e drejta për arsimim kërkon që:

- Fëmijët me nevoja të veçantatë mos përjashtohen nga sistemi i arsimit të përgjithshëm në bazë të aftësisë së kufizuar dhe nga arsimi fillor falas dhe i detyrueshëm, ose nga arsimi i mesëm, në bazë të aftësisë së kufizuar;
- Fëmijët me nevoja të veçantatë kenë qasje në një arsim fillor gjithëpërfshirës, cilësor dhe falas dhe në arsimin e mesëm në mënyrë të barabartë me të tjerët në komunitetet në të cilat ata jetojnë;
- Të ofrohen përshtatje të arsyeshme ndaj kërkesave të individit;
- Fëmijët me nevoja të veçantatë marrin mbështetjen e duhur, brenda sistemit të arsimit të rregullt, për të lehtësuar arsimimin e tyre efektiv;
- Të sigurohen masa efektive të mbështetjes së individualizuar në mjedise që maksimizojnë zhvillimin akademik dhe shoqëror në përputhje me qëllimin e gjithëpërfshirjes së plotë. (Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të kufizuara, 2006)

Kur fëmijët ndeshen me vështirësi në një ambient të fëmijërisë së hershme, nuk është e lehtë të identifikohet cili është problemi dhe më pas të gjehet mënyra për ta zgjidhur atë. Kodi i praktikës për nevojat e veçanta në edukim paraqet katër fusha të vështirësive:

- Komunikimi dhe ndërveprimi
- Vështirësitë ndjesore dhe/ose fizike
- Të kuptuarit dhe të nxënir
- Zhvillimi emocional, shoqëror dhe ai i sjelljes. (Glen, 2006)

1.1. Emërtimet për fëmijët me nevoja të veçanta

Emërtimet të cilat janë përdorur për fëmijët me nevoja të veçanta më herët kanë ndikuar që familjet e këtyre fëmijëve t'i mbajnë ata të mbyllur në shtëpi dhe të mos i lënë të shkollohen.

Shumë kohë më parë edhe vetë Aristoteli i simpoziumeve të lashta, i cili sundoi mendimin dhe filozofët e Perëndimit, i quajti personat me aftësi të kufizuara “të pagdhundur e të paaftë për të mësuar”. (Bennett, 2008)

“Në Francë, fillesat e përkujdesjes dhe të formave të arsimimit special për individët me aftësi të kufizuara datojnë shumë herët. Viti 1793 konsiderohet si datë simbolike e pikënisjes së reformave rehabilituese ndaj kësaj kategorie individësh. Është viti kur doktori Philippe Pinel mori lejen nga Komuna e Parisit për të liruar nga prangat 89 “të çmendur”. Deri në atë kohë “të çmendurit” ishin përzjerë bashkë me të dënuarit dhe kriminelët. Për herë të parë ata u quajtën “të sëmurë”, që meritonin trajtim e kujdes dhe ky ndryshim në qëndrim shënoi rritjen e psikiatrisë moderne, e cila duhej të përhapej në Europë. (Kulla, Remacka, & Ndrio, 2014)

Para 1990-s, fëmijët/individët me aftësi të kufizuara cilësoheshin me epitete, mbiemra e përcaktorë përçmues e me ngjyrimë negative e perjashtuese, si p.sh. i vonuar, nxënës i keq, debil, idiot, jonormal, budalla, i shëmtuar, i sëmurë, i çmendur, me të meta mendore, i mangët, embicilë në dallim nga të saktët, normalët, të bukurit. “Përdorimi i këtyre termave buronte më së shumti edhe nga modeli mjekësor i trajtimit të aftësisë së kufizuar, pasi edhe komisionet e përcaktimit të aftësisë së kufizuar operonin po me këto përcaktime.” (Ndrio, 2012)

1.2. Fëmijët me nevoja të veçanta dhe emërtimi i tyre në shoqërinë sot

Duke besuar që gjuha, si pjesa më e rëndësishme e bashkëveprimeve shoqërore, pasqyron proceset e ndryshimit dhe, akoma më ngushtë, lidhjet me normat shoqërore, patjetër që do të reflektojë gjuhësisht elementet e reja të proceseve gjithëpërfshirëse. Praktikant në fushën e edukimit kanë treguar që emërtimet e reja gjithëpërfshirëse janë njëkohësisht dhe konceptet e reja që lidhen me sjelljet dhe qëndrimet e hapura, pranuese dhe dashamirëse të komunitetit të shkollës dhe me gjerë. (Kulla, Remacka, & Ndrio, 2014)

Në vitet e fundit edhe zyrtarisht nga MASHT përdoret termi nxënës me nevoja të veçanta përmes të cilit kuptohen të gjithë nxënësit të cilët kanë vështirësi në procesin e arsimimit si pasojë e dëmtimeve. (Zabeli, Nxwnwsit me nevoja tw veçanta, 2001)

Emërtimet të cilat përdoren për fëmijët me vështirësi janë :

- Vështirësi në mësimnxënie të shkaktuara nga mungesa e vëmendjes/ çrregullim hiperaktiv
- Vështirësi në të nxënë në të lexuar- Disleksia
- Vështirësi në të nxënë në të shkruar- Disgrafia
- Vështirësi në të nxënë në veprime matematikore- Diskalkulia.

(Përkrahja e nxënësve me vështirësi në mësim, 2017)

Ndërsa për nxënësit të cilët kanë ngecje në zhvillim mendor/ prapambetje mendore përdoren emërtimet:

- Ngecje e zhvillimit mendor në shkallë të rëndë
- Ngecje e zhvillimit mendor në shkallë të mesme
- Ngecje e zhvillimit mendor në shkallë të lehtë. (Elshani, 2020)

1.3. Baza ligjore e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta

E drejta për arsim e fëmijëve me aftësi të kufizuara është një e drejtë themelore e tyre, e cila sanksionohet në aktet ndërkombëtare dhe kombëtare. Konventa më e re e Kombeve të Bashkuara, “Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, thekson detyrimin e shteteve palë për të njohur të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për edukim dhe për ta realizuar këtë të drejtë pa diskriminim, dhe në bazë të mundësive të barabarta. (E drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsim gjithëpërfshirës, 2012)

Edukimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin tonë arsimor është i lidhur ngushtë dhe mund të shihet nga këndvështrimi i nismës ligjvënëse të shtetit, gjë që në thelb shpreh detyrimin e shtetit për kujdesin ndaj këtyre fëmijëve në nivelin më të lartë ligjor (E drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsim gjithëpërfshirës, 2012)

Shtetet palë detyrohen të sigurojnë një sistem edukimi gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet, të orientuar drejt:

- zhvillimit të plotë të potencialit njerëzor, dinjitetit dhe vetvlerësimit; fuqizimit të respektit për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe diversitetit njerëzor;
- zhvillimit të personalitetit, talenteve dhe krijimtarisë së personave me aftësi të kufizuara, si dhe aftësive të tyre mendore dhe fizike, deri në potencialin e tyre të plotë;
- pjesëmarrjes efektive të personave me aftësi të kufizuara në një shoqëri të lirë.

(<https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>)

E drejta për arsim, e fëmijëve me aftësi të kufizuar është një e drejtë themelore e tyre, e cila sanksionohet në aktet ndërkombëtare dhe kombëtare. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës sanksionon detyrimin e shtetit për të njohur të drejtën për arsim me synimin për arritjen e kesaj të drejtë mbi baza barazie për të gjithë fëmijët duke e bërë arsimin bazë të detyruar, të arritshëm dhe të çliruar nga detyrimet financiare për të gjithë. Ky ligj detyron shtetet

nënshkruese të sigurojnë që arsimimi i fëmijëve të orientohet përkundrazi zhvillimit të personalitetit të fëmijës, talenteve dhe aftësive mendore e fizike për të arritur potencialin e tyre të plotë. (Kulla, Remacka, & Ndrio, 2014)

Në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës theksohet e drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuara për t'u arsimuar si të gjithë fëmijët e tjerë dhe në përputhje me kapacitetet e tyre mendore e fizike.

<https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>

Dokumentet që sigurojnë arsimin gjithëpërfshirës në Kosovë:

- Ligji mbi arsimin parauniversitar 2011- Gjithëpërfshirja si koncept e përshkon tere ligjin i cili është i bazuar në deklaratën e Salamankes mbi gjithëpërfshirjen dhe Konventën mbi të për drejtat e njeriut.
- Korniza e kurrikulimit të Kosovës (KKK) -Një nga parimet kryesore mbi të cilat është ndërtuar KKK është gjithëpërfshirja. KKK është në linjë me Arsimin për të Gjithë dhe Qëllimet Zhvillimore të Mileniumit.
- Standardet për edukimin parashkollor- siguron qasje gjithëpërfshirëse në edukimin hershem ku në qendër është fëmija dhe arritjet e tij në periudha të caktuara moshore dhe në fusha të ndryshme zhvillimi.
- Standardet për shkollat mike për fëmije- Koncepti i shkollave mike për fëmijë mbështetet në Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe paraqet qasje gjithëpërfshirëse që ndërlidh aspektet e reformës në arsim dhe e cila e vendos fëmijën në qendër të vëmendjes në të gjitha aktivitetet që organizohen dhe zbatohen në shkollë.
- Plani Strategjik për Arsimin e Kosovës 2011-2016 (PSAK)-Plani Strategjik për Arsimin e Kosovës 2011 -2016 (PSAK) është një plan pesëvjeçar që lidh arsimin gjatë gjithë jetës me përfshirjen në arsim dhe një model për të arritur të gjithë nxënësit si dhe ofron mundësi të barabarta në arsimim cilësor për të gjithë. Në këtë plan strategjik arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta i referohet Planit strategjik për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja te veçanta në arsimin parauniversitar 2010-2015 dokument ky i cili është hartuar ne vitin 2010.
- Plani individual i arsimit PIA- Plani individual i arsimit është dokument zyrtar pedagogjik i cili hartohet për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, për të cilët ekipi vlerësues i

ekspertëve të fushave të ndryshme zhvillimore ka marrë vendimin për edukim dhe arsimim me nevoja të veçanta.

(<http://arsimigjitheperfshires.rks.gov.net/ep-content/uploads/2020/05/Arsimi-gjith%C3%ABperfshir%C3%ABs-Broshure.pdf>)

1.4. Trajtimi i fëmijëve me nevoja të veçanta

Trajtimi i personave me nevoja të veçanta ka kaluar nëpër shumë faza gjatë historisë së shoqërive, që nga diskriminimi i skajshëm përmes kërkimfaljes e deri te pranimi përfundimtar.

Deri në shek. XIX ai trajtim, në përgjithësi, ka lëvizur në dy drejtime

- Në rastin e parë, fëmijët me nevoja të veçantakanë mbetur në familjet e tyre, larg syve të opinionit, janë fshehur dhe kanë qenë turp për familjen.
- Në rastin e dytë, ata kanë qenë të ndarë nga familjet dhe janë dërguar në institucione speciale, ku u është ofruar ushqim dhe strehim, por pa asnjë trajtim special, megjithëse përbërja ka qenë heterogjene sipas llojit të aftësive të kufizuara. (Zabeli, Nxwnwsit me nevoja tw veçanta, 2001)

Deri në vitet e tetëdhjeta të shekullit të kaluar nuk përmendet asgjë rreth punës profesionale, speciale dhe pedagogjike me fëmijët me nevoja të veçantaose, siç janë quajtur, personat me handikap. Çdo ndarje nga familja dhe mjedisi lokal paraqet segregacion, për shkak se fëmija mbetet pa familjen e vet. Në zhvillimin e fëmijës, i cili ballafaqohet me vështirësi të caktuara, një ndarje e tillë ka pasoja tjera negative. Prandaj, me kalimin e kohës, u krijuan kushte për lloje të ndryshme të mbrojtjes sociale, ku personat me aftësi të kufizuara, pas trajtimit ose angazhimit në punë, janë kthyer në familjet e tyre dhe janë ndjerë si pjesë e tyre. (Reçica-Havolli, 2014)

Arsyet kryesore dhe të mjaftueshme për segregacionin e personave me aftësi të kufizuara nga moshatarët e tyre në shkollat e rregullta kanë qenë kufizimet, mungesat dhe vështirësitë e tyre. Në fund të viteve të gjashtëdhjeta të shek. XX në botë filloi rishqyrtimi i arsyeshmërisë etike nga procesi i ndarjes së personave me aftësi të ndryshme të kufizuara nga të tjerët. Kështu në vitet e shtatëdhjeta dhe të tetëdhjeta, si rezultat i rishqyrtimit kritik të segregacionit të sistemit arsimor,

mungesave dhe mosukseseve të tij, rezultoi koncepti i normalizimit dhe integritit. (Zabeli, Edukimi inkluziv, 2022)

Përpyekja për përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në sistemin e rregullt arsimor daton nga vitet e tetëdhjeta të shekullit të kaluar, kur në provincat veriore kanadeze filluan të zhvillohen programe rreth inkluzionit të të gjithë fëmijëve. Shqyrtuar në nivel global, inkluzioni i fëmijëve në shkollat e rregullta, pa marrë parasysh aftësitë, prejardhjet ose kushtet socio-ekonomike në të cilat jetojnë e zhvillohen, është pjesë e lëvizjes mbarëbotërore për të drejtat e njeriut dhe orvatjet e tij janë në drejtim të përfshirjes së plotë të të gjithë personave me aftësi të kufizuara nga të gjitha aspektet e jetës shoqërore (Zabeli, Edukimi inkluziv, 2022)

II. PËRFSHIRJA E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË SISTEMIN SHKOLLOR NË KOMUNËN E GJILANIT

Kuptimi i përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollim nis nga qasja e themeluar mbi të drejtat e njeriut dhe nënkupton sigurim i të drejtat e barabarta për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrja e tyre e barabartë me të gjithë fëmijët e tjerë. Pika nisëse për këtë kuptim mbi kufizimit janë vlerat dhe parimet të përcaktuara me dokumente relevante ndërkombëtare, në radhën a parë Konventa e KB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Deklarata e UNESCO-s për arsim të bazuar mbi nevojat e posaçme nga Salamanka. (Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parafillor, 2018)

2.1. Statistikat për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta nga DKA

Në bazë të raportit statistikor për numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor të lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan kemi këto të dhëna

| | Mashkull | Femër | Total |
|---------|----------|-------|-------|
| Klasa 1 | 11 | 5 | 16 |
| Klasa 2 | 15 | 15 | 30 |
| Klasa 3 | 19 | 12 | 31 |
| Klasa 4 | 4 | 3 | 7 |
| Klasa 5 | 16 | 1 | 17 |
| Klasa 6 | 8 | 4 | 12 |
| Klasa 7 | 9 | 9 | 18 |
| Klasa 8 | 5 | 12 | 17 |
| Klasa 9 | 6 | 6 | 12 |

| Dëmtimi | Mashkull | Femër | Total |
|---|----------|-------|-------|
| Dëmtime intelektuale | 11 | 5 | 16 |
| Dëmtime në të dëgjuar | 1 | 5 | 6 |
| Dëmtime në të parë | 4 | 8 | 12 |
| Dëmtime fizike | 4 | 5 | 9 |
| Dëmtime të shumëfishta | 13 | 8 | 21 |
| Vështirësi në të folur, komunikim dhe të gjuhës | 20 | 15 | 35 |

| | | | |
|--|----|----|----|
| Autizëm | 19 | 12 | 31 |
| Sindromi Doën | 2 | 4 | 6 |
| Çrregullime emocionale dhe të sjelljes | 8 | 1 | 9 |
| Vështirësi/Çrregullime në të nxënë | 11 | 4 | 15 |

2.2. Statistikat për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta nga Shoqata e paraplegjikëve dhe e paralizës së fëmijëve të Gjilanit- HANDIKOS


Në bazë të raportit statistikor për numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta që marrin trajtim në HANDIKOS e që janë nxënës në arsimin fillor në komunën e Gjilanit kemi këto të dhëna

| Nr | Diagnoza | Moshë | | | | Gjinia |
|-----|---------------------------|----------|--------|---------|-------|--------|
| | | < 5 vjeç | 5-9 | 10-14 | 15-17 | |
| 1. | Autizëm | 4 vjeç | | | | F |
| 2. | Autizëm | 3 vjeç | | | | F |
| 3. | Autizëm | 3 vjeç | | | | |
| 4. | Paralizë cerebrale | | 7 vjeç | | | M |
| 5. | Paralizë cerebrale | | 7 vjeç | | | M |
| 6. | Paralizë cerebrale | | 7 vjeç | | | F |
| 7. | Paralizë cerebrale | | 8 vjeç | | | M |
| 8. | Hidrocefali | | 6 vjeç | | | M |
| 9. | Sindrom Doën | | 7 vjeç | | | M |
| 10. | Retardim Psiko-motorik | | 7 vjeç | | | M |
| 11. | Retardim Psiko-motorik | | 8 vjeç | | | M |
| 12. | Ngecje në zhvillim mendor | | 8 vjeç | | | M |
| 13. | Paralizë cerebrale | | 8 vjeç | | | F |
| 14. | Paralizë cerebrale | | | 12 vjeç | | M |
| 15. | Paralizë cerebrale | | | 13 vjeç | | M |
| 16. | Retardim Psiko-motorik | | | 14 vjeç | | M |
| 17. | Retardim Psiko-motorik | | | 14 vjeç | | F |
| 18. | Paralizë cerebrale | | | 14 vjeç | | F |
| 19. | Paralizë cerebrale | | | 13 vjeç | | F |
| 20. | Paralizë cerebrale | | | 11 vjeç | | M |

| | | | | | | |
|-----------|------------------------|------------|------------|------------|------------|--------------|
| 21. | Paralizë cerebrale | | | 10 vjeç | | F |
| 22. | Autizëm dhe epilepsi | | | 12 vjeç | | F |
| 23. | Retardim Psiko-motorik | | | 10 vjeç | | F |
| 24. | Paralizë cerebrale | | | 10 vjeç | | M |
| 25. | LCC | | | 13 vjeç | | M |
| 26. | Retardim Psiko-motorik | | | | 16 vjeç | M |
| 27. | Retardim Psiko-motorik | | | | 15 vjeç | F |
| 28. | Paralizë cerebrale | | | | 16 vjeç | F |
| 29. | Retardim Psiko-motorik | | | | 15 vjeç | M |
| 30. | Hemiparizë | | | | 16 vjeç | F |
| 31. | Retardim Psiko-motorik | | | | 18 vjeç | M |
| 32. | Retardim Psiko-motorik | | | | 15 vjeç | F |
| Gjithësej | | 2 F 1 M | 2 F 6 M | 6 F 6 M | 4 F 3 M | 14 F 18 M |

2.3. Statistikat për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta nga Qendra Sociale

Në bazë të raportit statistikor për numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor të lëshuar nga Qendra për Punë Sociale- Organi i Kujdestarisë në Gjilan kemi këto statistika të fëmijëve shfrytëzues të përkrahjes materiale:



- Çrregullime mendore 48.5 %
- Çrregullime fizike 47.1 %
- Çrregullime shqisore 4.4 %

Fëmijët paraplegjik, tetraplegjik dhe të verbërit marrin kompensim nga Departamenti i Pensioneve Invalidore të të rriturit sipas ligjeve të tjera.

2.4. Përfshirja e familjes në aspektin e vetëdijësimit për mosmohimin e arsimit

Hapi i parë dhe më i rëndësishmi që një prind mund të bëjë për fëmijën e tij me aftësi të kufizuara apo vështirësi në të nxënë, është të besojë në aftësitë e tij, të cilat janë të shumta. Janë prindërit personat e parë që duhet të realizojnë integrimin e fëmijë së tyre brenda ambjentit familjar dhe jashtë tij. (Këshilla praktike për prindërit me fëmijë me vështirësi në të nxënë dhe aftësi të kufizuara, 2010)

Prindërit duhet të pranojnë se të vlerësosh një arritje ka më shumë dobi sesa të vësh në dukje një mangësi, apo kufizim të fëmijës me vështirësi në të nxënë apo me aftësi të kufizuara, në çdo aspekt të jetës së tij. (Këshilla praktike për prindërit me fëmijë me vështirësi në të nxënë dhe aftësi të kufizuara, 2010)

Në bazë të informacioneve që kemi marrur nga Qendra për Punë Sociale në Gjilan, nuk është ende asnjë rast i fëmijëve që është braktisur për shkak të çrregullimit që ka.

2.5. Përfshirja e fëmijëve në moshën e hershme- Raport në çerdhe


Edukimi parashkollor është bazament i jetës për të gjithë fëmijët, pavarësisht aftësive të tyre. Zhvillimi i hershëm i fëmijës është një periudhë tepër e rëndësishme për formimin e personalitetit të fëmijës. Kopshtet e fëmijëve si pjesë e sistemit të rregullt edukativo-arsimor duhet të mundësojnë pjesëmarrje aktive dhe të barabartë për të gjithë fëmijët. Me qëllim që të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në procesin arsimor, fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtë për mbështetje individuale dhe për një qasje të individualizuar. (Shonkoff, 2011)

Në institucionet e edukimit të hershëm, fëmijët, përveçse në familjet e tyre, e kalojnë kohën më të madhe me fëmijët e tjerë dhe me edukatorët. Sidoqoftë, familja është baza e jetës së fëmijës dhe bashkëpunimi me prindërit është tejet i rëndësishëm për edukimin efektiv të tyre. Jeta dhe dinamikat familjare, përfshirë ndryshimet eventuale që mund të ndodhin në jetën e fëmijëve brenda familjes, ndikojnë përvojën e tyre në institucionet e edukimit të hershëm. Prandaj, njohja e karakteristikave të familjeve të fëmijëve është faktor esencial për të kuptuar më shumë për fëmijën dhe për ofrimin e edukimit cilësor për të. (Duraku, 2019)


Në bazë të raportit statistikor për numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta në parafillor përkatësisht në institucionin parashkollor “Ardhmëria 1” në Gjilan kemi këto të dhëna:

- Në institucionin parashkollor “Ardhmëria 1” janë 2 edukatore mbështetëse dhe janë 3 vajza dhe 3 djem me nevoja të veçanta.
- Në grupmoshën 4-5 vjeç fëmijët me nevoja të veçanta janë me dëmtime intelektuale dhe autizëm
- Në grupmoshën 5-6 vjeç fëmijët me nevoja të veçanta janë me sindrom doën, dëmtim intelektual dhe me dëmtim në të folur.

Grupmosha 4-5 vjeç



Grupmosha 5-6 vjeç



III. NDIKIMI I MËSIMDHËNËSIES NË PËRFSHIRJEN DHE SHKOLLIMIN E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Mësimdhënësit luajnë rol të rëndësishëm në sigurimin e pjesëmarrjes dhe suksesit në shkollim për të gjithë nxënësit. Nxënësit me nevoja të veçanta dhe me aftësi të kufizuara kanë nevojat e tyre arsimore shtesë dhe mësimdhënësit në shkollat e rregullta duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë. Është thelbësore që mësimdhënësit të trajnohen dhe të mbështeten për të bërë përshtatjet e nevojshme të mësimdhënies dhe për të modifikuar kurrikulën kur është e nevojshme për nxënësit me nevoja të veçanta dhe aftësi të kufizuara. (Kornizë për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në shkollat e mesme të larta, 2023)

Edhe Korniza Kurrikulare e Kosovës për arsimin parauniversitar thotë se rritja e përfshirjes së nxënësve në shkollim, përmirësimi i shkallës së mbarimit të shkollimit dhe të drejtat e barabarta gjinore do të varen nga përmirësimi i cilësisë në arsim, nga sigurimi i shpërndarjes së barabartë të burimeve dhe nga eliminimi i shkaqeve për ndërprerjen e shkollimit nga ana e fëmijëve që vijnë nga familjet e varfëra dhe grupet e marginalizuara të shoqërisë. (<https://masht.rks-gov.net/korniza-kurrikulare-e-arsimit-parauniversitar-te-republikes-se-kosoves/>)

Parimi i gjithëpërfshirjes në Kornizën Kurrikulare të Kosovës i referohet të drejtës së secilit fëmijë dhe të ri për qasje dhe përfshirje të barabartë në arsimim cilësor. E udhëhequr nga ky parim, Korniza Kurrikulare ofron zgjidhje të modifikueshme për t'i trajtuar dallimet e nxënësve në procesin e mësimdhënies dhe nevojat e tyre të veçanta, duke kontribuar që çdo fëmijë/nxënësi t'i ofrohet mundësia që të shpallë vlerat individuale, të ndjehet i pranuar, i vlerësuar dhe të përftojë maksimalisht nga procesi mësimor. (<https://masht.rks-gov.net/korniza-kurrikulare-e-arsimit-parauniversitar-te-republikes-se-kosoves/>)

Kështu që në këtë kontekst, Korniza Kurrikulare promovon:

- mjedis mësimor që mundëson qasje, akomodim dhe mbështetje për të gjithë nxënësit;
- promovimin e nxënies dhe pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor për të gjithë nxënësit, përfshirë nxënësit me nevoja të veçanta, talentët, gjenitë dhe ata me vështirësi në të nxënë;
- të nxënit që reflekton përvojat dhe informacionet paraprake të nxënësve; interesimet, potencialet, mundësitë, nevojat dhe stilet e të nxënit të tyre;

- planifikim të mësimdhënies duke marrë parasysh nevojat, përvojat dhe stilet e ndryshme të mësimnxënies së secilit nxënës;
- përfshirjen aktive të nxënësve në përzgjedhjen dhe planifikimin e përvojave të të nxënësve, duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e tyre dhe për të qenë në gjendje për të vetëvlerësuar rezultatet vetjake të të nxënësve. (<https://masht.rks-gov.net/korniza-kurrikulare-e-arsimit-parauniversitar-te-republikes-se-kosoves/>)

3.1. Plani Individual i Arsimit

Plani Individual i Arsimit është proces dhe praktikë përmes të cilit identifikohen arritjet dhe performanca funksionale e nxënësve mbi bazën e së cilës përshkruhen qëllimet dhe strategjitë për të përmbushur nevojat individuale të nxënësve në mënyrë që ata të arrijnë potencialin e tyre. Plani Individual i Arsimit kërkohet të zhvillohet për nxënës që kanë dëmtime të natyrave të ndryshme dhe aspekteve të tjera që vështirësojnë në masë të konsiderueshme procesin e të mësuarit të tyre, nxënës në rrezik që për shkak të ndryshme nuk arrijnë të përparojnë në mësim dhe të zhvillojnë potencialin e tyre. (Zabeli, Edukimi inkluziv, 2022)

Plani Individual i Arsimit është i rëndësishëm sepse:

- Mbështetë mësimdhënësin e klasës dhe shkollës për të zhvilluar një program kuptimplotë të të mësuarit për nxënësit për të ndjekur progresin e tij
- Ofron një mundësi për të ndarë informacione ndërmjet shkollës, nxënësit, familjes dhe mbështetjes tjetër të profesionistëve
- Ndihmon shkollat të përcaktojnë burimet e kërkuara për të arritur qëllimet e të mësuarit të nxënësit/es
- Promovon besimin dhe angazhimin e nxënësve përmes përfshirjes në proces. (Tremblay, 2012)

Plani Individual i Arsimit (PIA) është dokument zyrtar pedagogjik, i cili hartohet për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, për të cilët ekipi vlerësues komunal apo edhe ekipi në nivel institucioni ka marrë vendim për arsim me nevoja të veçanta arsimore. Plani Individual i Arsimit shërben për planifikimin sistematik të nxënies, mësimdhënies, për mbështetjen dhe ndjekjen e përparimit individual të fëmijës. (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10137>)

Plani individual i arsimit duhet të zhvillohet përmes një procesi bashkëpunues, duke përfshirë shkollën, prindërit, fëmijët (kur është e përshtatshme) dhe personelin tjetër përkatës. PIA është një dokument i besueshëm (konfidencial) dhe informatat për të mund t'u jepen të tjerëve vetëm me lejen e prindërve. Ai i referohet përshtatjes së kurrikulës dhe fokusohet në nevojat me prioritet të nxënësit. (<https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10137>)

Plani individual i arsimit shërben për mbështetjen dhe planifikimin e edukimit dhe arsimimit të fëmijëve dhe mësimeve, duke ofruar informata të strukturuar mirë për qëllimet individuale të nxënësve për mësim, mbështetje të nevojshme, synime të arritura dhe vlerësim. (<https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10137>)

Qëllimi parësor i PIA-s është që të mbështesë edukimin dhe arsimin e fëmijës, në mënyrë që ai/ajo të mund të përfitojë maksimalisht bazat përbrenda mundësive dhe potencialit të tij/saj apo të ndjekë kurrikulën e rregullt për aq sa është e mundur. Në PIA përcaktohen qëllimet afatshkurtra dhe afatgjata për nxënie të fëmijës, mbi të cilën planifikohet mbështetja përkatëse për të, në mënyrë që ai/ ajo të mund t'i arrijë rezultatet e të nxënësit. (Plani Individual i Arsimit (PIA) dhe Udhëzuesi për Hartimin e Planit Individual të Arsimit për Fëmijë me Nevoja të Veçanta Arsimore, 2017)

Plani Individual i Arsimit është i ndarë në tri pjesë:

- Pjesa administrative
 - o Mbledhë të dhënave kryesore të fëmijës për të cilat paraprakisht është pajtuar prindi ose kujdestari i tij
- Pjesa pedagogjike
 - o Të jep informata për gjendjen momentale të fëmijës
 - o Të përshkruhen qëllimet edukativo-mësimore
 - o Të përshkruhen lëndët e individualizuara
 - o Të përshkruhen fushat e aktiviteteve
 - o Të përshkruhet vlerësimi i arritjes së rezultateve të pritshme dhe vlerësimi i sistemit përkrahës.
- Pjesa rehabilituese
 - o Të mbledhë të dhëna për trajtimet e ofruara për fëmijën ose nxënësin

- Të ndajë përgjegjësitë dhe detyrat në mes të shkollës dhe të ofruesve të shërbimeve. (Plani Individual i Arsimit (PIA) dhe Udhëzuesi për Hartimin e Planit Individual të Arsimit për Fëmijë me Nevoja të Veçanta Arsimore, 2017)

3.2. Metodatat, teknikat dhe strategjitë e përshtatshme për fëmijët me nevoja të veçanta

Duke e ditur se shkolla e shekullit XXI kërkon mësuesin të përgatitur për të përmbushur përvojat e një popullësie gjithnjë e më të larmishme të nxënësve në klasat e tyre inkluzive mësuesin duhet të kenë parasysh edhe përshtatjen e metodave, teknikave dhe strategjive nevojave të nxënësve.

Një mësues i mirë duhet të ketë parasysh se në një klasë me 20 nxënës ka 20 botë të ndryshme, secili nga nxënësit është unik për nga mënyra e tij, ka një edukatë më ndryshe, kështu që këto ndikojnë që edhe të kenë një mësuesin ndryshe. (Zabeli, Edukimi inkluziv, 2022)

Nxënësit që shfaqin vështirësi të mëdha në të nxënë kanë motivim të ulët dhe pak besim në si nxënës e shpesh kanë ndjenja frustrimi e zhgënjimi. Ndonjëherë ato shprehen me zemërim e me sjellje sfiduese.

Nxënësit kanë më shumë gjasa të përfshihen në mësim kur detyrat mësimore janë afër me mundësitë e tyre e kur shohin se përpjekjet dhe arritjet u vlerësohen. Motivimi dhe vetëvlerësimi i këtyre nxënësve gjen përmirësim kur u jepen sfida për të arritur sukses por edhe mbështeten në përpjekjet e tyre e për më tepër kur këto suksese nënvizohen si duhet. (Zabeli, Edukimi inkluziv, 2022)

Nxënësit me aftësi të kufizuara mësojnë më mirë kur u krijohen mundësitë të:

- Përdorin materiale konkrete, të strukturuar dhe praktike ku përfshihen mjetet teknologjike (kompjuter, softëare, makina diktimi, korniza për shkrim, makina llogaritëse etj), mjete mësimore audiovizive për çdo lëndë si DVD-të dhe CD-të, mjetet grafike si grafikët, hartat tabelat, listat si dhe material konkret si forma gjeometrike, artfakte etj
- Përdorin material në nivelin e përshtatshëm për lexim duke shfrytëzuar edhe programe për lexim për të kuptuar tekstin dhe versionet audio të tij
- Kanë akses në tekste të pambingarkuara
- Mësojnë fjalorin e ri dhe gjuhën dhe terminologjinë e lëndëve

- Kanë kohën e mjaftueshme për mësim dhe plotësim të detyrave të shtëpisë dhe klasës
 - Përbushin me sukses detyrat, edhe pse kjo mund të kërkojë reduktim të vështirësisë a volumit të detyrave të vendosura për klasën
 - Prezantojnë punën e detyrat e kryera në mënyra të tjera alternative si psh të prezantojnë me gojë dhe jo me shkrim
 - Mësojnë, praktikojnë dhe luajnë me role aftësitë personale dhe shoqërore të mësuara në situata të ndryshme
- (Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollë, 2013)

Disa nga metodat më të përshtatshme për fëmijët me nevoja të veçanta në arsimin fillor janë:

- Qasje e modele të llojllojshme
- Mësimdhënia e diferencuar
- Inteligjencat e shumëfishta
- Të mësuarit në bashkëpunim
- Qendrat e të mësuarit
- Organizuesit grafikë (Zabeli, Edukimi inkluziv, 2022)

Disa nga strategjitë më të përshtatshme për fëmijët me nevoja të veçanta në arsimin fillor janë:

- Mësimdhënia Bashkëpunuese-Kjo strategji bën të mundur që nxënësi të marrë udhëzimet, ndërkohë që është në klasë me shokët. Kjo strategji mund të përdoret kryesisht në ato klasa ku ka një mësues ndihmës që lehtëson dhe përshtat mësimin për fëmijën me aftësi të kufizuara, ndërkohë që mësuesi i klasës jep informacion për të gjithë klasën, është i domosdoshëm.
- Patronazhi i shokut – është procesi në të cilin një nxënës i caktuar dhe udhëzuar nga mësuesi mëson një a disa nxënës të tjerë të mësojnë një aftësi a concept të caktuar.
- Mësimi i të gjithë nxënësve të klasës në grupe dyshe – është një mënyrë sesi e gjithë klasa ndahet në grupe dyshe dhe cdo grup ka të gjithë kohën e nevojshme të praktikojë e mësojë. Strategji të tjera bashkëpunuese përfshijnë: të nxënin e thelluar, mësimin e drejtuar, mësimin e pavarur, mësimin e bazuar në detyrë si dhe mësimin me kuptim
- Grupimi heterogjen – mësuesi zgjedh në mënyrë rastësore nxënës të klasës (me dhe pa aftësi të kufizuara) dhe dizajnon për ta detyra të caktuara që kërkojnë zgjidhje. Puna në të

tilla grupe, ka përfitime të mëdha, por kur planifikoni këto aktivitete grupi kini kujdes që të dizenjoni dhe monitoroni me kujdes aktivitetet. (Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollë, 2013)

IV. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Metodologjia e këtij punimi përfshin pjesën teorike dhe hulumtuese, pasi punimi i takon natyrës kërkimore. Për ta realizuar këtë hulumtim kemi përzgjedhur metodën kuantitative dhe kualitative (sasiore e cilësore). Për grumbullimin e të dhënave ne kemi përdorur informatat statistikore të DKA-se në Gjilan, si dhe kemi realizuar pyetësin me mësimdhënës në arsimin fillor.

4.1. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor në komunën e Gjilanit, me anë të këtij punimi synojmë analizimin e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor, si dhe mënyrat e përfshirjes së tyre brenda klasës inkluzive, në rastin tonë studimor, në komunën e Gjilanit.

4.2. Objektivat e hulumtimit

Objektivat e këtij hulumtimi janë:

- Mospërfshirja e duhur e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor
- Trajtim i duhur i fëmijëve me nevoja të veçanta
- Përdorimi i metodave dhe teknikave të duhura me fëmijë me nevoja të veçanta

4.3. Pyetjet e hulumtimit

Pyetjet e hulumtimit kanë rëndësi themelore në një hulumtim dhe i japin kahje shqyrtimeve. Pyetjet e hulumtimit kanë funksion të dyfishtë; shprehin qëllimin e hulumtimit, si dhe japin drejtim në procesin e hulumtimit. Sa më e vecantë dhe më e qartë që është pyetja e hulumtimit, aq më mirë do të jetë. (Ritchie, 1997)

Pyetja e hulumtimit është më shumë sesa një pohim i thjeshtë, sepse ajo duhet të përfshijë edhe disa detaje të natyrës së plotë të hulumtimit, prandaj çdo projekt i caktuar hulumtues ka pyetjet e veta specifike. (Matthews & Ross, 2010)

Pyetjet e hulumtimit, për realizimin e këtij punimi janë:

- Sa janë të përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta në arsimin fillor në komunën e Gjilanit ?
- Cilat janë vështirësitë me të cilat përballen fëmijët me nevoja të veçanta në arsimin fillor ?
- Sa shërbimet profesionale merren me fëmijët me nevoja të veçanta përveç mësuesit të klasës?

4.4. Hipotezat e punimit

Hipotezat janë një lloj i veçantë pyetjeje hulumtimi që në fakt nuk është pyetje. Hipoteza është një pohim i testueshëm për marrëdhënien ose marrëdhëniet midis dy ose më shumë koncepteve. (Ritchie, 1997)

Hipotezat si pohime të testueshme, nuk përdoren vetëm për ato hulumtime ku të dhënat mbledhen dhe testohen me anë të mjeteve statistikore. Ato janë bazë edhe për hulumtimet ku mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nuk është aq i strukturuar dhe i njehsueshëm. (Matthews & Ross, 2010)

Hipotezat përdoren më rëndom për të shqyrtuar marrëdhëniet midis koncepteve që janë statistikisht të testueshme. (Matthews & Ross, 2010)

Për përcaktimin e objektit të hulumtimit dhe formulimit të problemit, kemi formuluar këto hipoteza:

- Fëmijët me nevoja të veçanta janë të përfshirë në arsimin fillor në komunën e Gjilanit pjesërisht.
- Mësimdhënësit e klasës dhe mësimdhënësi mbështetës merren me zhvillimin e fëmijët me nevoja të veçanta.

4.5. Populacioni dhe mostra

Në kuptim statistikor popullata është numri tërësor i rasteve që mund të përfshihen si objekte hulumtimi. (Matthews & Ross, 2010)

Popullata mund të përfshijë:

- Të gjithë njerëzit që jetojnë në një vend
- Të gjithë studentët që studiojnë në një universitet të caktuar
- Të gjithë studentët që studiojnë në të njëjtën degë në të gjitha universitetet e një vendi, në një kohë të caktuar (Ritchie, 1997)

Marrja e mostrave lidhet me përzgjedhjen e një nëngrupi individësh nga brenda një popullate për të vlerësuar karakteristikat e të gjithë popullsisë. Dy avantazhet kryesore të kampionimit janë mbledhja më e shpejtë e të dhënave dhe kosto më e ulët. (Richard L. Scheaffer, 1986)

Hulumtimi për mbledhjen e të dhënave do të bëhet në institucionet edukativo-arsimore të nivelit 1-5 të Republikës së Kosovës në Komunën e Gjilanit.

Popullacionin e këtij hulumtimi do ta përfshijnë psikologët e shkollave, mësimdhënësit mbështetës, asistentët e fëmijëve me nevoja të veçanta si dhe mësimdhënësit e klasave 1-5. Ky studim do të bëhet në zona urbane dhe rurale të komunës së Gjilan-it. Shkollat fillore që do të përfshihen në hulumtim:

- “Thimi Mitko”-Gjilan
- “Sadulla Brestovci”- Gjilan,
- “Vatra e Diturisë”- Livoç i Epërm,
- “Skënderbeu”- Përlepnice,
- “Nazim Hikmet”- Dobërçan

Mostëre keti hulumtim janë 94 individë, që janë mësimdhënës klasor, psikolog të shkollave, asistent të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe mësimdhënës mbështetës.

4.6. Instrumentet e hulumtimit

Pyetësorët janë mënyra më e zakonshme për të mbledhur të dhëna nga pjesëmarrësit në hulumtim. Pyetësi është një format që lejon grumbullimin e të dhënave të standardizuara, relativisht të strukturuar për secilin nga një numër i madh rastesh. (Matthews & Ross, 2010)

Pyetësi është një grup pyetjesh të cilave pjesëmarrësit në hulumtim mund t’iu përgjigjen në një varg mënyrash, shumica e pyetësorëve kanë për qëllim të mbledhin të dhëna paraprakisht të strukturuar dhe përmbajnë një grup përgjigjesh nga të cilat i anketuari mund të zgjedhë, ndonëse në disa pyetësorë mund të përfshihen pyetje të hapura që i lejojnë të anketuarit t’iu përgjigjen atyre sipas mënyrës së vet. (Matthews & Ross, 2010)

Për grumbullimin e të dhënave për studimin tonë do të përdoret një pyetësorë. Pyetësori është i standardizuar dhe përbëhet nga 21 pyetje ku pyetje janë të gjitha me opsione, duke pasur për bazë formën krahasuese.

4.7. Përpunimi i rezultateve


Përpunimi i rezultateve të pyetësorit të realizuar me 94 mësues të shkollave fillore: “Vatra e Diturije”, “Thimi Mitko”, “Skënderbeu”, “Nazim Hikmet” dhe “Sadulla Brestovci”, do të bëhet me programin SPSS.

V. INTERPRETIMI I REZULTATEVE

Tabela 1- Pyetja e parë (Mosha juaj)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja valide | Përqindja kumulative |
|---------------------|---------------|-----------|------------------|----------------------|
| 23-30 Vjeç | 20 | 21.3 | 21.3 | 21.3 |
| 31-40 vjeç | 36 | 38.3 | 38.3 | 59.6 |
| Më shumë se 40 vjeç | 38 | 40.4 | 40.4 | 100.0 |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | 100.0 | |

Grafikoni 1- Mosha juaj




*Në pyetjen e parë- **Mosha juaj**- 20 mësimdhënës (21.3%) janë të moshës 23-30 vjeç, 36 mësimdhënës (38.3%) janë të moshës 31-40 vjeç dhe 38 mësimdhënës (40.4%) janë të moshës më shumë se 40 vjeç*

Tabela 2- Pyetja e dytë (Gjinia juaj)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|----------|---------------|-----------|------------------|----------------------|
| Femër | 78 | 83.0 | 83.0 | 83.0 |
| Mashkull | 16 | 17.0 | 17.0 | 100.0 |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | 100.0 | |

Grafikoni 2- Gjinia juaj




Gjinia juaj:

*Në pyetjen e dytë-**Gjinia juaj**- 78 mësimehënës (83.0%) janë të gjinisë femërore dhe 16 mësimehënës (17.0%) janë të gjinisë mashkullore.*

Tabela 3- Pyetja e tretë (Përvoja e punës në arsimin fillor)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|---------------------|---------------|-----------|------------------|----------------------|
| 0-5 vjet | 21 | 22.3 | 22.3 | 22.3 |
| 6-10 vjet | 21 | 22.3 | 22.3 | 44.7 |
| 11-15 vjet | 25 | 26.6 | 26.6 | 71.3 |
| Më shumë se 16 vjet | 27 | 28.7 | 28.7 | 100.0 |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | 100.0 | |

Grafikoni 3- Përvoja e punës në arsimin fillor




Në pyetjen e tretë-Përvoja e punës në arsimin fillor- 21 mësimdhënës (22.3%) janë përgjigjur 0-5 vjet përvojë të punës, 21 mësimdhënës (22.3%) janë përgjigjur 6-10 vjet përvojë të punës, 25 mësimdhënës (26.6%) janë përgjigjur 11-15 vjet përvojë të punës dhe 27 mësimdhënës (28.7%) janë përgjigjur më shumë se 16 vite përvojë të punës.

Tabela 4- Pyetja e katërt (Niveli i kualifikimit akademik)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|----------|---------------|-----------|------------------|----------------------|
| Bachelor | 68 | 72.3 | 72.3 | 72.3 |
| Master | 26 | 27.7 | 27.7 | 100.0 |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | 100.0 | |

Grafikoni 4-Niveli i kualifikimit akademik



Në pyetjen e katërt- Niveli i kualifikimit akademik- 68 mësimdhënës (72.3 %) janë me Bachelor, 26 mësimdhënës (27.7%) janë me Master, ndërsa me doktoraturë nuk është asnjë mësimdhënës.

Tabela 5- Pyetja e pestë (Shkolla mundëson dhe mbështet gjithëpërfshirjen në çdo rast)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|----------|---------------|-----------|---------------------|-------------------------|
| PO | 83 | 88.3 | 88.3 | 88.3 |
| JO | 7 | 7.4 | 7.4 | 95.7 |
| Nuk e di | 4 | 4.3 | 4.3 | 100.0 |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | 100.0 | |

Grafikoni 5-Shkolla mundëson dhe mbështet gjithëpërfshirjen në çdo rast



Në pyetjen e pestë- **Shkolla mundëson dhe mbështet gjithëpërfshirjen në çdo rast**- 83 mësimdhënës (88.3%) kanë pohuar se shkolla mundëson dhe mbështet gjithëpërfshirjen në çdo rast, 7 mësimdhënës (7.4%) janë përgjigjur me jo dhe 4 mësimdhënës (4.3%) kanë dhënë përgjigjen nuk e di për pyetjen e parashtruar.

Tabela 6- Pyetja e gjashtë (A keni nxënës me nevoja të veçanta në klasën tuaj ?)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|----------|---------------|-----------|---------------------|-------------------------|
| Po | 44 | 46.8 | 46.8 | 46.8 |
| Jo | 50 | 53.2 | 53.2 | 100.0 |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | 100.0 | |

Grafikoni 6-A keni nxënës me nevoja të veçanta në klasën tuaj ?



Në pyetjen e gjashtë-A keni nxënës me nevoja të veçanta në klasën tuaj ?- 44 mësues (46.8%) kanë pohuar se kanë nxënës me nevoja të veçanta në klasën e tyre dhe 50 mësues (53.2%) kanë treguar se nuk kanë nxënës me nevoja të veçanta në klasën e tyre.

Tabela 7-Pyetja e shtatë (Sa nxënës me nevoja të veçanta keni në klasën tuaj ?)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|-----------------|---------------|-----------|---------------------|-------------------------|
| Një | 34 | 36.2 | 36.2 | 36.2 |
| Dy | 6 | 6.4 | 6.4 | 42.6 |
| Më shumë se tre | 4 | 4.3 | 4.3 | 46.8 |
| Asnjë | 50 | 53.2 | 53.2 | 100.0 |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | 100.0 | |

Grafikoni 7-Sa nxënës me nevoja të veçanta keni në klasën tuaj ?



Në pyetjen e shtatë-Sa nxënës me nevoja të veçanta keni në klasën tuaj ?- 34 mësimitdhënës (36.2%) kanë treguar se kanë 1 nxënës me nevoja të veçanta në klasat e tyre, 6 mësimitdhënës (6.4%) kanë treguar se kanë 2 nxënës me nevoja të veçanta në klasat e tyre, 4 mësimitdhënës (4.3%) kanë treguar se kanë më shumë se 3 nxënës me nevoja të veçanta në klasat e tyre dhe 50 mësimitdhënës (53.2%) kanë treguar se nuk kanë asnjë nxënës me nevoja të veçanta në klasat e tyre.

Tabela 8- Pyetja e tetë (Puna me nxënës me nevoja të veçanta është sfidë në punën time)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|----------|---------------|-----------|------------------|----------------------|
| Po | 61 | 64.9 | 64.9 | 64.9 |
| Jo | 15 | 16.0 | 16.0 | 80.9 |
| Nuk e di | 18 | 19.1 | 19.1 | 100.0 |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | 100.0 | |

Grafikoni 8-Puna me nxënës me nevoja të veçanta është sfidë në punën time




Në pyetjen e tetë-**Puna me nxënës me nevoja të veçanta është sfidë në punën time**- 61 mësimdhënës (64.9 %) kanë thënë që puna me nxënës me nevoja të veçanta është sfidë në punën e tyre, 15 mësimdhënës (16.0%) kanë thënë që puna me nxënës me nevoja të veçanta nuk është sfidë në punën e tyre dhe 18 mësimdhënës (19.1%) nuk kanë pasur përgjigje për këtë pyetje dhe janë përgjigjur me nuk e di.

Tabela 9- Pyetja e nëntë (Cilës kategori i takojnë nxënësit me nevoja të veçanta që keni në klasën tuaj ?)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|------------------------|---------------|-----------|------------------|----------------------|
| Dëmtim intelektual | 13 | 13.8 | 14.0 | 14.0 |
| Dëmtim në të dëgjuar | 2 | 2.1 | 2.2 | 16.1 |
| Dëmtim në të pare | 6 | 6.4 | 6.5 | 22.6 |
| Dëmtime të shumëfishta | 4 | 4.3 | 4.3 | 26.9 |
| Autizëm | 4 | 4.3 | 4.3 | 31.2 |
| Sindrom Doën | 2 | 2.1 | 2.2 | 33.3 |
| Hiperaktivitet | 8 | 8.5 | 8.6 | 41.9 |
| Të tjera | 9 | 9.6 | 9.7 | 51.6 |
| Asnjëra nga këto | 45 | 47.9 | 48.4 | 100.0 |
| Gjithësej | 93 | 98.9 | 100.0 | |
| Nuk janë përgjigjitur | 1 | 1.1 | | |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | | |

Grafikoni 9-Cilës kategori i takojnë nxënësit me nevoja të veçanta që keni në klasën tuaj ?




Në pyetjen e nëntë- Cilës kategori i takojnë nxënësit me nevoja të veçanta që keni në klasën tuaj ?- 13 mësime (13.8%) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta që kanë në klasë i takojnë kategorisë- dëmtim intelektual, 2 mësime (2.1%) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta që kanë në klasë i takojnë kategorisë- dëmtim në të dëgjuar, 6 mësime (6.4%) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta që kanë në klasë i takojnë kategorisë- dëmtim në të parë, 4 mësime (4.3%) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta që kanë në klasë i takojnë kategorisë- dëmtime të shumëfishta, 4 mësime (4.3%) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta që kanë në klasë i takojnë kategorisë- autizëm, 2 mësime (2.1%) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta që kanë në klasë i takojnë kategorisë- autizëm, 8 mësime (8.5%) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta që kanë në klasë i takojnë kategorisë- hiperaktivitet, 9 mësime (9.6%) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta që kanë në klasë i takojnë kategorisë- të tjera dhe 45 mësime (47.9%) kanë thënë që pasi që nuk kanë nxënës me nevoja të veçanta në klasë nuk i takojnë asnjërës nga këto kategori.

Tabela 10- Pyetja e dhjetë (Shkolla ku punoni a ka burime të mjaftueshmë didaktike, burime dhe mjete ndihmëse për punën me nxënësit me nevoja të veçanta ?)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|----------|---------------|-----------|------------------|----------------------|
| Po | 45 | 47.9 | 47.9 | 47.9 |
| Jo | 39 | 41.5 | 41.5 | 89.4 |
| Nuk e di | 10 | 10.6 | 10.6 | 100.0 |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | 100.0 | |

Grafikoni 10-Shkolla ku punoni a ka burime të mjaftueshmë didaktike, burime dhe mjete ndihmëse për punën me nxënësit me nevoja të veçanta ?

Shkolla ku punoni ka burime të mjaftueshme didaktike burime dhe mjete ndihmëse për punën me nxënësit me nevoja të veçanta



Shkolla ku punoni ka burime të mjaftueshme didaktike burime dhe mjete ndihmëse për punën me nxënësit me nevoja të veçanta

Në pyetjen e dhjetë- *Shkolla ku punoni a ka burime të mjaftueshmë didaktike, burime dhe mjete ndihmëse për punën me nxënësit me nevoja të veçanta ?*-45 mësimitdhënës (47.9 %) kanë thënë që shkolla ku punojnë ka burime të mjaftueshme didaktike për nxënës me nevoja të veçanta, 39 mësimitdhënës (41.5%) kanë thënë që shkolla ku punojnë nuk ka burime të mjaftueshme didaktike për nxënës me nevoja të veçanta dhe 10 mësimitdhënës (10.6%) kanë thënë që nuk e dinë a ka mjaftueshëm burime didaktike shkolla ku punojnë.

Tabela 11- Pyetja e njëmbëdhjetë (Sa janë të përfshirë në procesin mësimor nxënësit me nevoja të veçanta në klasën tuaj ?)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|---------------------|---------------|-----------|------------------|----------------------|
| Shumë | 36 | 38.3 | 41.9 | 41.9 |
| Pak | 28 | 29.8 | 32.6 | 74.4 |
| Aspak | 22 | 23.4 | 25.6 | 100.0 |
| Gjithësej | 86 | 91.5 | 100.0 | |
| Nuk janë përgjigjur | 8 | 8.5 | | |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | | |

Grafikoni 11-Sa janë të përfshirë në procesin mësimor nxënësit me nevoja të veçanta në klasën tuaj ?



Në pyetjen e njëmbëdhjetë- Sa janë të përfshirë në procesin mësimor nxënësit me nevoja të veçanta në klasën tuaj ?- 36 mësime nxënës (41.9 %) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta në klasën e tyre janë të përfshirë shumë, 28 mësime nxënës (32.6%) kanë thënë që nxënësit me

nevoja të veçanta në klasën e tyre janë të përfshirë pak dhe 22 mësimdhënës (25.6%) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta në klasën e tyre nuk janë të përfshirë aspak.

Tabela 12- Pyetja e dymbëdhjetë (A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon në zhvillimin e empatisë tek fëmijët e tjerë ?)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|----------|---------------|-----------|------------------|----------------------|
| Shumë | 47 | 50.0 | 50.0 | 50.0 |
| Pak | 39 | 41.5 | 41.5 | 91.5 |
| Aspak | 8 | 8.5 | 8.5 | 100.0 |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | 100.0 | |

Grafikoni 12-A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon në zhvillimin e empatisë tek fëmijët e tjerë ?



Në pyetjen e dymbëdhjetë- A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon në zhvillimin e empatisë tek fëmijët e tjerë ?- 47 mësimehënës (50 %) kanë thënë që përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon shumë në zhvillimin e empatisë tek fëmijët e tjerë, 39 mësimehënës (41.5%) kanë thënë që përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në klasë kontribon pak në zhvillimin e empatisë tek fëmijët e tjerë dhe 8 mësimehënës (8.5%) kanë


thënë që përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në klasë nuk kontribon aspak në zhvillimin e empatisë tek fëmijët e tjerë.

Tabela 13- Pyetja e trembëdhjetë (A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon në zhvillimin e aftësive sociale ?)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|----------|---------------|-----------|------------------|----------------------|
| Shumë | 52 | 55.3 | 55.3 | 55.3 |
| Pak | 41 | 43.6 | 43.6 | 98.9 |
| Aspak | 1 | 1.1 | 1.1 | 100.0 |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | 100.0 | |

Grafikoni 13-A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon në zhvillimin e aftësive sociale ?

A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon në zhvillimin e aftësive sociale



A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon në zhvillimin e aftësive sociale

Në pyetjen e trembëdhjetë- **A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon në zhvillimin e aftësive sociale ?**- 52 mësuesdhënës (55.3%) kanë thënë që përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon shumë në zhvillimin e aftësive sociale, 41 mësuesdhënës (43.6%) kanë thënë që përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në klasë kontribon


pak në zhvillimin e aftësive sociale dhe 1 mësimdhënës (1.1%) ka thënë që përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në klasë nuk kontribon aspak në zhvillimin e aftësive sociale.

Tabela 14- Pyetja e katërmbëdhjetë (A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon në zhvillimin e një kulture gjithëpërfshirëse ?)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|----------|---------------|-----------|------------------|----------------------|
| Shumë | 61 | 64.9 | 64.9 | 64.9 |
| Pak | 32 | 34.0 | 34.0 | 98.9 |
| Aspak | 1 | 1.1 | 1.1 | 100.0 |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | 100.0 | |

Grafikoni 14-A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon në zhvillimin e një kulture gjithëpërfshirëse ?

A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në shkollë/klasë ndikon në zhvillimin e një kulture gjithëpërfshirëse



A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në shkollë/klasë ndikon në zhvillimin e një kulture gjithëpërfshirëse

Në pyetjen e katërmbëdhjetë- **A mendoni se përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon në zhvillimin e një kulture gjithëpërfshirëse ?**- 61 mësime (64.9 %) kanë thënë që përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon shumë në zhvillimin e një kulture gjithëpërfshirëse, 32 mësime (34.0%) kanë thënë që përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë kontribon pak në zhvillimin e një kulture gjithëpërfshirëse dhe 1 mësime

(1.1%) ka thënë që përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë nuk kontribon aspak në zhvillimin e një kulture gjithëpërfshirëse.

Tabela 15- Pyetja e pesëmbëdhjetë (A kanë asistente nxënësit me nevoja të veçanta në klasën tuaj ?)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|---------------------|---------------|-----------|------------------|----------------------|
| Po | 18 | 19.1 | 20.0 | 20.0 |
| Jo | 66 | 70.2 | 73.3 | 93.3 |
| Nuk e di | 6 | 6.4 | 6.7 | 100.0 |
| Gjithësej | 90 | 95.7 | 100.0 | |
| Nuk janë përgjigjur | 4 | 4.3 | | |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | | |

Grafikoni 15-A kanë asistente nxënësit me nevoja të veçanta në klasën tuaj ?



Në pyetjen e pesëmbëdhjetë- **A kanë asistente nxënësit me nevoja të veçanta në klasën tuaj ?**- 18 mësimdhënës (41.9 %) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta që janë në klasën e tyre kanë asistente, 66 mësimdhënës (32.6%) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta që janë në klasën e tyre nuk kanë asistente dhe 6 mësimdhënës (25.6%) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta që janë në klasën e tyre nuk e dinë a kanë asistente.

Tabela 16- Pyetja e gjashtëmbëdhjetë (Sa iu ndihmon mësimdhënësia mbështetëse nxënësve me nevoja të veçanta që janë në klasën tuaj ?)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|---------------------|---------------|-----------|------------------|----------------------|
| Aspak | 28 | 29.8 | 35.0 | 35.0 |
| Pak | 25 | 26.6 | 31.3 | 66.3 |
| Shumë | 27 | 28.7 | 33.8 | 100.0 |
| Gjithësej | 80 | 85.1 | 100.0 | |
| Nuk janë përgjigjur | 14 | 14.9 | | |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | | |

Grafikoni 16-Sa iu ndihmon mësimdhënësia mbështetëse nxënësve me nevoja të veçanta që janë në klasën tuaj ?



Në pyetjen e gjashtëmbëdhjetë-Sa iu ndihmon mësimdhënësia mbështetëse nxënësve me nevoja të veçanta që janë në klasën tuaj?- 27 mësimdhënës (28.7 %) kanë thënë që mësimdhënësia mbështetëse iu ndihmon shumë nxënësve me nevoja të veçanta që kanë në klasën e tyre, 25

mësimdhënës (26.6%) kanë thënë që mësimdhënësia mbështetëse iu ndihmon pak nxënësve me nevoja të veçanta që kanë në klasën e tyre dhe 28 mësimdhënës (29.8%) kanë thënë që mësimdhënësia mbështetëse nuk iu ndihmon aspak nxënësve me nevoja të veçanta që kanë në klasën e tyre, 14 mësimdhënësit e tjerë që nuk janë përgjigjgur në këtë pyetje arsyetohen me pjesën që nuk kanë mësimdhënëse mbështetëse në shkollë.

Tabela 17- Pyetja e shtatëmbëdhjetë (Nxënësit me nevoja të veçanta që janë në klasën tuaj a kanë Plan Individual të Arsimit ?)

| | | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|----------------------|----------|---------------|-----------|------------------|----------------------|
| Valid | Po | 37 | 39.4 | 44.0 | 44.0 |
| | JO | 37 | 39.4 | 44.0 | 88.1 |
| | Nuk e di | 10 | 10.6 | 11.9 | 100.0 |
| | Gjithsej | 84 | 89.4 | 100.0 | |
| Nuk janë përgjigjgur | | 10 | 10.6 | | |
| Gjithsej | | 94 | 100.0 | | |

Grafikoni 17-Nxënësit me nevoja të veçanta që janë në klasën tuaj a kanë Plan Individual të Arsimit ?




Në pyetjen e shtatëmbëdhjetë- Nxënësit me nevoja të veçanta që janë në klasën tuaj a kanë Plan Individual të Arsimit ?- 37 mësimdhënës (39.4 %) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta në klasën e tyre kanë Plan Individual të Arsimit, 37 mësimdhënës (39.4%) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta në klasën e tyre nuk kanë Plan Individual të Arsimit dhe 10 mësimdhënës

(10.6%) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta në klasën e tyre nuk e dinë a kanë Plan Individual të Arsimit.

Tabela 18- Pyetja e tetëmbëdhjetë (Kush mban mësim plotësues me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollën tuaj ?)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|---------------------------|---------------|-----------|------------------|----------------------|
| Mësimdhënësja e klasës | 32 | 34.0 | 35.2 | 35.2 |
| Mësimdhënësja mbështetëse | 29 | 30.9 | 31.9 | 67.0 |
| Asnjëra nga këto | 22 | 23.4 | 24.2 | 91.2 |
| Nuk e di | 8 | 8.5 | 8.8 | 100.0 |
| Gjithësej | 91 | 96.8 | 100.0 | |
| Nuk janë përgjigjur | 3 | 3.2 | | |
| Gjithësej | 94 | 100.0 | | |

Grafikoni 18-Kush mban mësim plotësues me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollën tuaj ?



Në pyetjen e tetëmbëdhjetë- **Kush mban mësim plotësues me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollën tuaj ?**, 32 mësimdhënës (34.0 %) kanë thënë që mësimin plotësues me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat e tyre e mbanë mësimdhënësja e klasës, 29 mësimdhënës (30.9%) kanë thënë që mësimin plotësues me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat e tyre e mbanë

mësimdhënësja mbështetëse, 22 mësimdhënës (25.6%) kanë thënë që mësimin plotësues me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat e tyre nuk e mban asnjëra dhe 8 mësimdhënës (8.5%) kanë thënë që nuk e dinë se kush e mban mësimin plotësues në shkollat e tyre.

Tabela 19- Pyetja e nëntëmbëdhjetë (Sa punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollën tuaj shërbimi profesionist ?)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|----------|---------------|-----------|------------------|----------------------|
| Shumë | 42 | 44.7 | 44.7 | 44.7 |
| Pak | 24 | 25.5 | 25.5 | 70.2 |
| Aspak | 19 | 20.2 | 20.2 | 90.4 |
| Nuk e di | 9 | 9.6 | 9.6 | 100.0 |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | 100.0 | |

Grafikoni 19-Sa punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollën tuaj shërbimi profesionist ?




Në pyetjen e nëntëmbëdhjetë- Sa punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollën tuaj shërbimi profesionist ?, 42 mësimdhënës (44.7 %) kanë thënë që me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat e tyre punojnë shumë shërbimi profesionist, 24 mësimdhënës (25.5%) kanë thënë që me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat e tyre punojnë pak shërbimi profesionist, 19 mësimdhënës (20.2%) kanë thënë që me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat e tyre nuk

punojnë aspak shërbimi profesionist dhe 9 mësimdhënës (9.6%) kanë thënë që nuk e dinë sa punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat e tyre shërbimi profesionist.

Tabela 20-Pyetja e njzet (Cilat nga këto strategji përdorni me nxënësit me nevoja të veçanta ?)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|---------------------------|---------------|-----------|------------------|----------------------|
| Mësimdhënia e diferencuar | 21 | 22.3 | 24.1 | 24.1 |
| Mësimdhënia bashkëpunuese | 44 | 46.8 | 50.6 | 74.7 |
| Tjera | 22 | 23.4 | 25.3 | 100.0 |
| Gjithsej | 87 | 92.6 | 100.0 | |
| Nuk janë përgjigjur | 7 | 7.4 | | |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | | |

Grafikoni 20-Cilat nga këto strategji përdorni me nxënësit me nevoja të veçanta ?




Në pyetjen e njzet- Cilat nga këto strategji përdorni me nxënësit me nevoja të veçanta 21 mësimdhënës (22.3 %) kanë thënë që me nxënësit me nevoja të veçanta përdorin mësimdhënien e diferencuar, 44 mësimdhënës (46.6%) kanë thënë që me nxënësit me nevoja të veçanta përdorin mësimdhënien bashkëpunuese, 22 mësimdhënës (23.4%) kanë thënë që me nxënësit me nevoja të veçanta përdorin strategji të tjera dhe asnjë mësimdhënës (0%) nuk ka thënë që përdor patronazhin e shokut me nxënësit me nevoja të veçanta.

Tabela 21-Pyetja e njëzet e një (Mësimdhënësit duhet të marrin pjesë në trajnime profesionale për të punuar me nxënësit me nevoja të veçanta)

| | Pjesëmarrësit | Përqindja | Përqindja Valide | Përqindja Kumulative |
|----------|---------------|-----------|------------------|----------------------|
| Po | 91 | 96.8 | 96.8 | 96.8 |
| Jo | 2 | 2.1 | 2.1 | 98.9 |
| Nuk e di | 1 | 1.1 | 1.1 | 100.0 |
| Gjithsej | 94 | 100.0 | 100.0 | |

Grafikoni 21-Mësimdhënësit duhet të marrin pjesë në trajnime profesionale për të punuar me nxënësit me nevoja të veçanta

Mësimdhënësit duhet të marrin pjesë në trajnime profesionale për të punuar me nxënësit me nevoja të veçanta



Në pyetjen e njëzet e një- **Mësimdhënësit duhet të marrin pjesë në trajnime profesionale për të punuar me nxënësit me nevoja të veçanta**, 91 mësimdhënës (96.8 %) kanë thënë që mësimdhënësit duhet të marrin pjesë në trajnime profesionale për të punuar me nxënësit me nevoja të veçanta, 2 mësimdhënës (2.1%) kanë thënë që mësimdhënësit nuk duhet të marrin pjesë në trajnime profesionale për të punuar me nxënësit me nevoja të veçanta dhe 1 mësimdhënës (1.1%) ka thënë që nuk e di a duhet mësimdhënësit të marrin pjesë në trajnime profesionale për të punuar me nxënësit me nevoja të veçanta.

5.1. Argumentimi i pyetjeve të hulumtimit

Sa janë të përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta në arsimin fillor në komunën e Gjilanit ?

Përmes hulumtimit kemi arritur të kuptojmë se nxënësit me nevoja të veçanta në arsimin fillor në komunën e Gjilanit nuk janë të përfshirë shumë në klasat e rregullta në bazë të të dhënave që kemi ku 36 mësimdhënës (41.9 %) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta në klasën e tyre janë të përfshirë shumë, 28 mësimdhënës (32.6%) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta në klasën e tyre janë të përfshirë pak dhe 22 mësimdhënës (25.6%) kanë thënë që nxënësit me nevoja të veçanta në klasën e tyre nuk janë të përfshirë aspak.?

Vështirësitë me të cilat përballen fëmijët me nevoja të veçanta në arsimin fillor janë mungesa e burimeve të mjaftueshme didaktike për nxënës me nevoja të veçanta në nivel shkolle (41.5%) si dhe mungesa e asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta në klasa të rregullta (70.2%).

Sa mirren me fëmijët me nevoja të veçanta shërbimi profesionist përveç mësimdhënësit të klasës?

Sipas të dhënave të grumbulluara nga ky hulumtim vërehet se shërbimi profesionist punojnë shumë me nxënësit me nevoja të veçanta (44.7 %).

6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

6.1. Përfundime

Duke u bazuar në literaturën e rishikuar vërejmë se termi nxënës me nevoja të veçanta përfshin të gjithë nxënësit, të cilët kanë vështirësi në procesin e arsimimit si pasojë e dëmtimeve si: prapambetje mendore, dëmtime në të parë, dëmtime në të dëgjuar, vështirësi në komunikim, çrregullime emocionale dhe të sjelljes, dëmtime fizike, vështirësi specifike në të mësuar, por edhe nxënës që kanë vështirësi në arsimim për shkak të gjuhës, etnisë, statusit ekonomik-social apo çfarëdo qofshin ato.

Kategoritë më të shpeshta që i takojnë fëmijët me nevoja të veçanta në arsimin fillor në komunën e Gjilanit janë:

- *Dëmtime intelektuale (16 nxënës)*
- *Dëmtime në të dëgjuar (6 nxënës)*
- *Dëmtime në të parë (12 nxënës)*
- *Dëmtime fizike (9 nxënës)*
- *Dëmtime të shumëfishta (21 nxënës)*
- *Vështirësi në të folur, komunikim dhe të gjuhës (35 nxënës)*
- *Autizëm (31 nxënës)*
- *Sindrom Doën (6 nxënës)*

Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor në komunën e Gjilanit ka filluar të shënoj ngritje fatmirësisht, e krejt kjo është bërë falë punës së madhe që bëjnë mësuesit me këta nxënës si dhe punësimi i mësuesve mbështetës dhe përkrahjes së madhe që marrin këta fëmijë nga shërbimi profesionist.

Sigurimi i burimeve të mjaftueshme didaktike për nxënës me nevoja të veçanta, si dhe punësimi i asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta do ta lehtësonin edhe më shumë përfshirjen dhe shkollimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor.

Në përgjithësi, bashkëpunimi me prindër është çelësi kryesor në krijimin e një mjedisi pozitiv shkollor, si dhe është njëri ndër faktorët kryesor në përparimin shkollimit të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Ne si mësimdhënës duhet të bëjmë më të mirën e mundshme, që edhe fëmijët me nevoja të veçanta të përfshihen plotësisht në proces mësimor, sepse edhe ata janë nxënës të klasës ku ne japim mësim.

6.2. Rekomandime

Disa nga rekomandimet, të cilat mund të ndikojnë në përfshirjen më të madhe të fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor

1. **Trajnim profesional për mësime për fëmijë me nevoja të veçanta:** Mësuesit duhet të ndjekin trajnime të cilat ndihmojnë ata në lidhje me strategjitë e menaxhimit dhe inkurajimit të fëmijëve me nevoja të veçanta në proces mësimor, si dhe përpilimin e Planit Individual të Arsimit.
2. **Hapësira mbështetëse dhe të sigurt:** Shkolla e ka për detyrë që të ofroj një mjedis të sigurt dhe mbështetës për të gjithë nxënësit pa marrë parasysh dallimet mes tyre. Këtu përfshihen krijimin i një mjedisi pozitiv, përkrahja nga mësuesi/ja dhe shokët/shoqet e klasës, krijimi i kushteve të përshtatshme.
3. **Materiale të mjaftueshme didaktike për nxënësit me nevoja të veçanta:** Duhet të bëhet çmos si nga shkolla ashtu edhe nga instancat më të larta që për fëmijët me nevoja të veçanta të ketë burime të mjaftueshme didaktike, në mënyrë që ata ta kenë më të lehtë përvetësimin e njohurive të reja dhe konkretizimin e tyre.
4. **Asistente për fëmijë me nevoja të veçanta:** Shtimi i numrit të asistentëve nëpër klasa do të jetë një ndihmesë shumë e madhe si për mësuesin/en e klasës ashtu edhe për fëmijët me nevoja të veçanta, që të kemi sa më shumë sukses tek fëmijët me nevoja të veçanta na duhet ndihma edhe e asistentes pa anashkaluar faktin se na shërben shumë edhe ndihma e shërbimit profesionist të shkollës.
5. **Bashkëpunim të vazhdueshëm me prindër:** Një ndihmë e madhe për mësuesin është bashkëpunimi i vazhdueshëm me prindër, në këtë mënyrë ata do të jenë në dijeni për përparimin dhe vështirësitë që hasin nxënësit me nevoja të veçanta në një problem të caktuar. Ky bashkëpunim do të ndikojë pozitivisht në parteritetin shkollë-familje.

7. BIBLIOGRAFIA

Accessing factors that contribute to the practical implementation of inclusive education. (2012).
World Vision, 12-15.

Arsimi Gjithëpërfshirës marrë nga:

<http://arsimigjithheperfshires.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/05/Arsimi-gjith%C3%ABperfshir%C3%ABs-Broshure.pdf>

Bejtullahu, E. (2007). *Njohuritë mbi aftësinë e kufizuar dhe rehabilitimi*. Prishtinë.

Bennett, S. D. (2008). *Special educaton in Ontario Schools, sixth edition*. Hillsboro: Highland Press.

Duraku, Z. H. (2019). *Edukimi në fëmijërinë e hershme*. Prishtinë: Media Print.

E drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsim gjithëpërfshirës. (2012). Prishtine: World Vision.

Elshani, H. (2020). *Prapambetja mendore/ Aftësi e kufizuar*. Tiranë: Universiteti i Tiranës.

Gal, E. (2010). INCLUSION OF CHILDREN WITH DISABILITIES. *International Journal of Special Education*, 12-14.

Glen, A. (2006). *Strategji të provuara dhe të testuara*. Britani e Madhe: David Fulton.

Këshilla praktike për prindërit me fëmijë me vështirësi në të nxënë dhe aftësi të kufizuara. (2010). Tiranë: Save the children.

Konveta mbi të Drejtat e Fëmijës marrë nga:

<https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të kufizuara . (2006). Nju Jork: Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të kufizuara .

Kornizë për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në shkollat e mesme të larta. (2023). Prishtinë: MASHT.

Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës marrë nga:

<https://masht.rks-gov.net/korniza-kurrikulare-e-arsimit-parauniversitar-te-republikes-se-kosoves/>

Kulla, F., Remacka, L., & Ndrio, M. (2014). *Jam mes jush*. Tiranë: World Vision.

Ligji Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës marrë nga:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>

Matthews, B., & Ross, L. (2010). *Metodat e hulumtimit*. Tirane: Qendra per Arsim Demokratik.

Ndrio, M. (2012). *The impact of gender roles and stereotypes in experience of mothers and fathers of children with special needs*. . Tirane: University of Tirana, Faculty of Social Science.

Udhëzim Administrativ Nr.18/2023 Përdorimi i Planit Individual të Arsimit marrë nga :

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10137>

Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parafillor. (2018). Shkup: Bibloteka kombëtare dhe universitare "Sht Kliment Ohridiski".

Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollë. (2013). Tiranë: Save the children.

Përkrahja e nxënësve me vështirësi në mësim. (2017). Shkup: Bibloteka dhe universitare "Sht. Kliment Ohridiski ".

Plani Individual i Arsimit (PIA) dhe Udhëzuesi për Hartimin e Planit Individual të Arsimit për Fëmijë me Nevoja të Veçanta Arsimore. (2017). Prishtina: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Reçica-Havolli, S. (2014). *Kërkime pedagogjike*. Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës.

Richard L. Scheaffer, W. M. (1986). *Elementary survey sampling, 3rd edition*. Duxbury: Duxbury Press.

- Ritchie, J. d. (1997). *Qualitative Research Practice: A guide for social science students and researchers*. London: Sage.
- Shonkoff, J. P. (2011). *Special Edition of the Science Journal Supports the Need for Greater Attention to Preschool*. Brazil: Correio Braziliense.
- Stankovska, G. (2011). *Education of student with special education needs* . Tetova: Universiteti i Tetovës.
- Tremblay, P. a. (2012). *Individualizes Education Plans in Canada, A comparative Analysis* . Canada: International Journal for Cross-Disciplinary Subjects in Education.
- Turku, A. (2002). *Hyrje në edukimin special*. Sejko: Universiteti Aleksander Xhuvani.
- Vasilica, C. (2010). the school inclusion of children ëith special needs. *Elsevier*, 4325-4329.
- Zabeli, N. (2001). *Nxënësit me nevoja të veçanta*. Prishtine: KEC & Save the children.
- Zabeli, N. (2022). *Edukimi inkluziv*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Zhapaj, A., Sulaj, E., & Caushi, K. (2019). *Mbi aftësinë e kufizuar*. Fier: Ymeraj I.

SHTOJCAT

Pyetësi për mësimdhënës

PYETËSOR

Të nderuar pjesëmarrës,

Ju mirëpresim në këtë studim hulumtues, që synon të zbuloj përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor si dhe përkrahjen e tyre nga të tjerët përveç mësimdhënësit të klasës. Ky pyetësor është një pjesë e studimit tim të diplomës dhe synon të marrë një perspektivë të thelluar mbi mendimet dhe vlerësimet e juaja në lidhje me përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Të gjitha të dhënat e mbledhura gjatë këtij studimi do të trajtohen me një nivel të lartë konfidencialiteti dhe do të përdoren ekskluzivisht për qëllimet e hulumtimit. Përgjigjet e juaja do të jenë një kontribut i çmuar për të kuptuar më mirë rreth përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta dhe përkrahjes së tyre në arsimin fillor.

Nëse keni ndonjë pyetje, paqartësi apo dëshironi një kopje të raportit përfundimtar të studimit, ju lutem të na kontaktoni në email adresën : edlire.zymberi.st@uni-gjilan.net

Ju faleminderit për bashkëpunim !

Mosha juaj

- a) 23-30 vjeç
- b) 31-40 vjeç
- c) Më shumë se 40 vjeç

Gjinia juaj

- a) Femër
- b) Mashkull

Përvoja e punës në arsimin fillor

- a) 0-5 vjet
- b) 6-10 vjet
- c) 11-15 vjet
- d) Më shumë se 16 vjet

Niveli i kualifikimit akademikë

- a) Bachelor
- b) Master
- c) Doktoraturë

A keni nxënës me nevoja të veçanta në klasën tuaj

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

Sa nxënës me nevoja të veçanta keni në klasën tuaj

- a) Një
- b) Dy
- c) Më shumë se tre
- d) Asnjë

Cilës kategori i takojnë nxënësit me nevoja të veçanta që keni në klasën tuaj ?

- a) Dëmtim intelektual
- b) Dëmtim në të dëgjuar
- c) Dëmtim në të parë
- d) Dëmtime të shumëfishta
- e) Të tjera
- f) Asnjëra nga këto

Sa janë të përfshirë në procesin mësimorë nxënësit me nevoja të veçanta në klasën tuaj

- a) Shumë
- b) Pak
- c) Aspak

Sa janë të përfshirë në aktivitete nxënësit me nevoja të veçanta në klasën tuaj

- a) Shumë
- b) Pak
- c) Aspak

A kanë asistente nxënësit me nevoja të veçanta në klasën tuaj

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

Sa iu ndihmon mësimdhënësja mbështetëse nxënësve me nevoja të veçanta që janë në klasën tuaj

- a) Aspak
- b) Pak
- c) Shumë

Nxënësit me nevoja të veçanta që janë në klasën tuaj a kanë Plan Individual të Arsimit

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

Kush mban mësim plotësues me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollën tuaj

- a) Mësimdhënësja e klasës
- b) Mësimdhënësja mbështetëse
- c) Asnjëra nga këto
- d) Nuk e di

Sa mirren me nxënësit me nevoja të veçanta në shkollën tuaj shërbimi profesionist

- a) Shumë
- b) Pak
- c) Aspak
- d) Nuk e di

Cilat nga këto strategji përdorni me nxënësit me nevoja të veçanta ?

- a) Mësimdhënia e diferencuar
- b) Patronazhi i shokut
- c) Mësimdhënia bashkëpunuese
- d) Tjera

Raporti nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan




REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E GJILANIT
 OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT
 UPRAVA ZA OBRAZOVANJE
 DEPARTMENT OF EDUCATIO

LISTË DISTRIBUIMI/CIRKULARNO PISMO/ROUTING SLIP/

| | | | | | |
|---|---------------------------------------|------------|-----|--------|------------|
| REFERENC-Ë: | | | | | |
| PËR/ZA/TO: | Znj. Edlirë Zymberi | | | | |
| NGA/OD/FROM: | Msc. Liridona Kosumi, Zyrtarë per FNV | | | | |
| PERMES; | | | | | |
| TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT: | Përgjigje në Kërkesë | | | | |
| Nr. i Zyrës: | | Lokacioni: | | Data: | |
| Br. Kancelarije: | O2 | Lokacija: | DKA | Datum: | 29.05.2023 |
| Room No: | | Extencion: | | Date: | |
| PËR AKTIVITETE/ ZA AKTIVNOST/ FOR ACTION | | | | | |
| PËR MIRATIM / ZA USVAJANJE/ FOR APPROVAL | | | | | x |
| PËR NËNSHKRIM/ ZA POTPIS / FOR SIGNATURE | | | | | |
| PËR KOMENTE / ZA KOMENTARE / FOR COMMENTS | | | | | |
| A MUND TË DISKUTOJMË/ DALI MOZEMO RASPRAVLJATI / MAY ËE DISCUSS | | | | | |
| VËMENDJA E JUAJ/ VASA PAZNJA/ YOUR ATTENTION | | | | | |
| SIPAS DISKUTIMIT/ KAKOJE RASPRAVLJENO / AS DISCUSSED | | | | | |
| SIÇ ËSHTË KËRKUAR/ KAKO JE ZATRAZENO / AS REQUESTED | | | | | |
| SHËNIM DHE PËRGJIGJE / BELESKA I ODGOVOR / NOTE AND RETURN | | | | | x |
| PËR INFORMIMIN TUAJ/ ZA VASU INFORMACIJU/ FOR YOUR INFORMATION/ | | | | | |
| AFATI/ ROK/DEADLINE/ | | | | | |

E nderuar Znj. Edlirë Zymberi,

Pas shqyrtimit të kërkesës suaj nr. 05-610/08-0029348/24, të dt. 20 .03.2024, ku keni kërkuar raport statistikor për numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin fillor.

Ju njoftojmë se Drejtoria Komunale e Arsimit e aprovon kërkesën tuaj.

| | Mashkull | Femër | Total |
|---------|----------|-------|-------|
| Klasa 1 | 11 | 5 | 16 |
| Klasa 2 | 15 | 15 | 30 |
| Klasa 3 | 19 | 12 | 31 |
| Klasa 4 | 4 | 3 | 7 |
| Klasa 5 | 16 | 1 | 17 |
| Klasa 6 | 8 | 4 | 12 |
| Klasa 7 | 9 | 9 | 18 |
| Klasa 8 | 5 | 12 | 17 |
| Klasa 9 | 6 | 6 | 12 |

| Dëmtime intelektuale | Mashkull | Femër | Total |
|---|----------|-------|-------|
| | 11 | 5 | 16 |
| Dëmtime në të dëgjuar | Mashkull | Femër | Total |
| | 1 | 5 | 6 |
| Dëmtime në të parë | Mashkull | Femër | Total |
| | 4 | 8 | 12 |
| Dëmtime fizike | Mashkull | Femër | Total |
| | 4 | 5 | 9 |
| Dëmtime të shumëfishta | Mashkull | Femër | Total |
| | 13 | 8 | 21 |
| Vështirësi në të folur, komunikim dhe të gjuhës | Mashkull | Femër | Total |
| | 20 | 15 | 35 |
| Autizëm | Mashkull | Femër | Total |
| | 19 | 12 | 31 |
| Sindromi Daun | Mashkull | Femër | Total |
| | 2 | 4 | 6 |

| Çrregullime emocionale dhe të sjelljes | Mashkull | Femër | Total |
|--|----------|-------|-------|
| | 8 | 7 | 9 |
| Vështirësi/Çrregullime në të nxënë | Mashkull | Femër | Total |
| | 11 | 4 | 15 |

Ju lutemi për mirëkuptimin tuaj.

Raporti nga HANDIKOS








12/24

| Nr | Diagnoza | Moshë | | | | Gjinia |
|----|---------------------------|----------|----------|-----------|----------|-------------|
| | | < 5 vjeq | 5-9 | 10-14 | 15-17 | |
| 1 | Autizëm | 4-VJEQ | | | | F |
| 2 | Autizëm | 3-VJEQ | | | | F |
| 3 | Autizëm | 3-VJEQ | | | | |
| 4 | Paralizë cerebrale | | 7-VJEQ | | | M |
| 5 | Paralizë cerebrale | | 7-VEQ | | | M |
| 6 | Paralizë cerebrale | | 7-VJEQ | | | F |
| 7 | Paralizë cerebrale | | 8-VJEQ | | | M |
| 8 | Hidrocefali | | 6-VJEQ | | | M |
| 9 | Sindrom doën | | 7- VJEQ | | | M |
| 10 | Retardim Psiko-motorik | | 7-VJEQ | | | M |
| 11 | Retardim Psiko-motorik | | 8-VJEQ | | | M |
| 12 | Ngecje në zhvillim mendor | | 8-VJEQ | | | M |
| 13 | Paralizë cerebrale | | 8-VJEQ | | | F |
| 14 | Paralizë cerebrale | | | 12-VJEQ | | M |
| 15 | Paralizë cerebrale | | | 13-VJEQ | | M |
| 16 | Retardim Psiko-motorik | | | 14-VJEQ | | M |
| 17 | Retardim Psiko-motorik | | | 14-VJEQ | | F |
| 18 | Paralizë cerebrale | | | 14-VJEQ | | F |
| 19 | Paralizë cerebrale | | | 13-VJEQ | | F |
| 20 | Paralizë cerebrale | | | 11-VJEQ | | M |
| 21 | Paralizë cerebrale | | | 10-VJEQ | | F |
| 22 | Autizëm dhe epilepsi | | | 12-VJEQ | | F |
| 23 | Retardim Psiko-motorik | | | 10-VJEQ | | F |
| 24 | Paralizë cerebrale | | | 10-VJEQ | | M |
| 25 | LCC (kukin e nxjerrtë) | | | 13-VJEQ | | M |
| 26 | Retardim Psiko-motorik | | | | 16-VJEQ | M |
| 27 | Retardim Psiko-motorik | | | | 15-VJEQ | F |
| 28 | Paralizë cerebrale | | | | 16-VJEQ | F |
| 29 | Retardim Psiko-motorik | | | | 15-VJEQ | M |
| 30 | Hemiparizë | | | | 16-VJEQ | F |
| 31 | Retardim Psiko-motorik | | | | 18-VJEQ | M |
| 32 | Retardim Psiko-motorik | | | | 15-VJEQ | F |
| | GJITHESEJT | 2 F-1 M | 2 F- 8 M | 6 F – 6 M | 4 F – 3M | 14 F – 18 M |

Puntore Psiko-Sociale Naxhije Salihu



Raporti nga Qendra për Punë Sociale në Gjilan

| | |
|--|--|
|  <p>REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURİYETİ KOMUNA E GJILANIT - OŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIJE Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale Uprava za Zdravstvo i Socialno Blagostanje Sağlık ve Sosyal Güvenlik Müdürlüğü QPS-CSR-CST 4/1</p> <p>Nr./Br./No. <u>04-023337</u> Dl. <u>20.03.2024</u> GJILAN - GNJILANE - GILAN</p> | |
|  <p>REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E GJILANIT OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI</p>  | |
| Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Social / Direktorat za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu / Department of Health and Social Welfare | |
| Qendra për Punë Sociale në Gjilan | |
| DATE/A: | 20.03.2024 04-29337 |
| REFERENC-Ë: | |
| PËR/ZA/TO: | Studenten Edlirë Zymberi |
| CC: | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Mursel Zymberi-Drejtor  |
| NGA/OD/FROM: | Mehat Berisha-Shef i Shërbimit Social  |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Përgjigje ne kërkesën tuaj –Raporti statistikor lidhur me FFAK fëmije shfrytëzues te përkrahjes materiale. |

Të nderuar.

Me anë të kësaj shkrese, QPS-Organi i Kujdestarisë në Gjilan , ju njofton lidhur me statistikat e FFAK shfrytëzues te përkrahjes familjare sipas kërkesës s tuaj:

Raste aktive gjithsej 173 .

48.5% çrregullime mendore
47.1 çrregullime fizike,
4.4% shqisore

Vërejtje: dy kategoritë e fëmijëve qe nuk janë te përfshira ne ketë statistike janë, fëmijët paraplegjik ,tetraplegjiket dhe te verbrit te cilët marrin kompensim ne Departamentin e Pensioneve Ivalidore te të rriturit sipas ligjeve te tjera.

“Me respekt”

Raporti nga institucioni parashkollor “Ardhmëria I”



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



IP ARDHMERIA 1

Nr prot 25/2024
Data.24.04.2024

Raport per F.N.V

Me kerkese te znj. Edlirë Zymberi dhe me leje të DkA-sëe lëshojmë kete raport të dhëna per fëmijët me nevoja te veqanta ne IP“Ardhmeria1”.

Në IP“Ardhmeria1” në Gjilan punojnë dy edukatore mbështetëse secila me nga 3 fëmijë.

Në dy grupet i kemi 3 vajza e 3 djem me diagnoza te ndryshme .

Në grupin 4-5 kemi femije me damtimintelektual dhe me autizem .

Ne grupin 5-6 kemi fëmijë me sindrom down me dëmtim intelektual, dhe me damtim ne te folur.

Drejtore Mirvete Hoxha

